# REPUBLIKA E SHQIPËRISË
# UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
# FAKULTETI I BIZNESIT

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë**

**Master i Shkencave në "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"**

**i Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës**

Grupi i Vlerësimit të brendshëm:

1. Dr. Arjeta Hallunovi *(Koordinatori i programit të studimit)*
2. Dr. Rovena Vangjel *(Lektore e Departamentit të Financë Kontabilitetit)*
3. Dr. Proces Elfrida Taraku *(Lektore e Departamentit të Financë Kontabilitetit)*
4. Dr. Marsela Resulaj *(Përfaqësues Biznesi)*
5. Msc. Elgesa Beqiri *(Studente , MSc Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut)*
6. Dr. Spiro Paco *(Koordinatori Institucional i IAL pranë ASCAL)*
7. Marsida Dyrmishi *(Përfaqësuese e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë)*

Mars, 2023

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

**Master i Shkencave në "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"**

Programi i studimit **Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"** i ofruar nga Universiteti "Aleksandër Mosiu", Fakulteti i Biznesit, Departamenti i Financë - Kontabilitetit është hapur në vitin akademik 2012 - 2013 me VKM Vendim Nr.282, datë 04.07.2013. Emërtimi i programit të studimit **Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"** është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Kuadri i përgjithshëm formues i këtij programi është hartuar duke marrë në konsideratë:

- **Ligji Nr. 80/2015, datë 25.07.2015,** "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".
- **Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 801 dt. 20.12.2005** "Për hapjen e Universitetit "Aleksandër Moisiu' në Durrës".
- **Udhëzimin Nr.30 datë 26.09.2007** të MASH "Për Përcaktimin e Proçedurave dhe Dokumentacionit që duhet të paraqesë subjekti juridik për hapjen e një Institucioni Privat të Arsimit të Lartë ose Programeve të reja të studimit të Ciklit të Parë dhe të Dytë të Studimeve", i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 29. dt. 28. 07. 2008 të MASH.
- **Nr. 14 dt. 03.04.2008** i MASH "Për Hapjen dhe Organizimin e Programeve të Ciklit të Dytë në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë".
- **Udhëzimi Nr.31, datë 29.12.2017** "Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve te studimit nga institucionet e Arsimit te Larte", Rregullore studimeve të Masterit.
- **VKM Nr.41, datë 24.01.2018** "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë.
- **Ligjin Nr.8480, datë. 27.05.1999** "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" të statusit neni 19 dhe 21, rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës, neni 17,023 dhe 25.

Programi i studimit **Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"** është një përzierje unike e sigurimit, menaxhimit të rrezikut dhe përmbajtjes së shërbimeve financiare. Këto fusha po bëhen gjithnjë e më të ndërlidhura dhe përparësia e menaxhimit të rrezikut dhe sigurimeve si një profesion i specializuar ka vazhduar të rritet në një mjedis ekonomik kompleks dhe të paqëndrueshëm. Tashmë, është e njohur që axhenda e biznesit është larguar nga shmangia e rrezikut drejt njohjes së tij, i cili nëse menaxhohet siç duhet, mund të çojë në avantazh konkurues të biznesit. Që nga hapja, ky program ka ofruar metoda moderne mësimdhënie, kurrikula bashkëkohore, bashkëpunime kërkimore-shkencore, praktika profesionale dhe aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare për studentët dhe stafin akademik. Prandaj, ky program bën që studentët të ndihen të plotësuar për t'i bërë ballë sfidave

në karrierën e tyre brenda dhe jashtë vendit. Studentët ndërmjet këtij programi studimi, kanë mundësi punësimi në një gamë të gjerë organizatash, duke përfshirë kompanitë e sigurimeve dhe ri-sigurimeve, firmat kryesore të kontabilitetit, departamentet e menaxhimit të rrezikut, autoritetet rregullatore dhe shumë fusha të tjera, në institucione në nivel qendror dhe lokal, institucione kërkimore-shkencore, etj.
Programi i studimit **Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"** filloi në vitin akademik 2012-2013 me 13 studentë, dhe ky trend është mbajtur gjatë viteve akademike në vazhdim në intervale të përafërta. Në vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 ka patur një rritje të numrit të studentëve, ku sipas statistikave të regjistrimit janë regjistruar përkatësisht 12 dhe 17 studentë.

Bazuar në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë", Strategjinë kombëtare për zhvillim dhe Integrim, si dhe në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 (SKA), rezulton se programi i studimit Master Shkencor në "Industria e Sigurimit dhe Drejtimit të Riskut", është program studimi prioritar pasi përgatit profesionet në fushat e financave, sigurimeve dhe riskut duke përmbushur Objektivin strategjik III (Investimi në kapital njerëzor dhe kohezion social) (MAS). Ky objektiv kërkon rritje në cilësinë e arsimit dhe përshtatjen e programeve të studimit me nevojat e tregut të punës, nevojave për zhvillim kombëtar dhe rajonal dhe procesit të integrimit në BE. Gjithashtu ky program është në linjë me Objektivin specifik C.2 të SKA-së (Nxitja e përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor). Ky objektiv kërkon rritje në cilësinë e arsimit duke krijuar mundësi për personelin akademik dhe studentët të fitojnë aftësi për kërkime të pavarura, në funksion të zhvillimit të qendrueshëm profesional dhe të karrierës akademike.

**Parimet e punës së GVB**

Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për programin e studimit **Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"** është përgatitur nga një grup i ngritur me Vendim Nr. 86, datë 07.02.2023, në përputhje me dispozitat ligjore të MASR dhe ASCAL, si dhe me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. Grupi i punës ka patur në vëmendje për hartimin e raportit kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse, specifikisht udhëzimet e ASCAL-it, dhe dokumentet e vendosura në dispozicion nga Institucioni. Grupi i punës i RVB **Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"** është udhëhequr nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.

*Përshkrimi i punës për RVB e programit të studimit **Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"**:*

- Paraqitja e kërkesës së IAL për vlerësim dhe shqyrtimi i saj nga ASCAL dhe Këshilli i Akreditimit.
- Miratimi i kërkesës dhe përcaktimi i afateve kohore të vlerësimit nga ASCAL.
- Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm, Vendim nr. 86, datë 07/02/2023.
- Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas manualit të ASCAL. Gjatë kësaj faze GVB ka qëndruar në kontakt të vazhdueshëm me Drejtorinë e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë dhe ASCAL.
- Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm sipas kërkesave e udhëzimeve në manualin e ASCAL dhe pas konsultimit të përmbajtjes së tij me stafin e njësisë.
- Dorëzimi në ASCAL i RVB në afatet e përcaktuara.

RVB përbëhet nga *6 rubrika kryesore*. Çdo rubrikë ka standartet dhe kriteret përkatëse përmes së cilës kërkohet të analizohet. Në pjesën e vlerësimit cilësor sipas standardeve GVB-ja është përgjigjur konkretisht për çdo kriter dhe për çdo standard, nëse plotësohet apo jo dhe specifikisht evidencat përkatëse. Raporti Vlerësimit të Brendshëm duhet të përmbajë vlerësimin e GVB për këto çështje:

I. Ofrimi i Programeve të Studimit
II. Organizimi, Drejtimi dhe Administrimi i Programeve të Studimit të Ciklit të dytë
III. Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat
IV. Burimet Njerëzore, Financiare, Infrastruktura, Logjistika për Realizimin e Programit të Studimit
V. Studentët dhe mbështetja e tyre
VI. Sigurimi i Cilësisë së Programeve të studimit

## Shkurtimet

*UAMD - Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës*
*FB - Fakulteti i Biznesit*
*Dep. FK - Departamenti Financë Kontabilitet*
*NJSBC - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë*
*MSC ISDR - Master i Shkencave Industria dhe Sigurimit dhe Drejtimi i Rrezikut*
*NJK - Njësia Kryesore*
*NJB - Njësia Bazë*
*AMF - Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare*
*AADF - Albanian American Development Foundation*
*ASCAL - Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë*
*SBSC - Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë*
*GVB - Grupi i vlerësimit të brendshëm*
*TKP - Treguesit kyç të përformancës*
*RVB - Raporti i Vlerësimit të Brëndshëm*
*DKSC - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë*
*IAL - Institucioni i Arsimit të Lartë*

# Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | *Po.* Institucioni i Arsimit të Lartë harton programe studimi që janë në shërbim të interesave kombëtare, ne shërbim të kombit dhe të shtetit, duke u bazuar në kreun 1, neni 1 për Ligjin e Arsimit të Lartë, 2015[1]. Institucioni është i përkushtuar ndaj idealeve të qasjes, angazhimit, udhëheqjes, dhe shërbimit të cilat sjellin përfitime praktike në fushën e arsimit, të shtetit, kombit dhe komunitetit global duke u bazuar në vizionin e Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës[2]. Synimi mbetet një sistem arsimor gjithëpërfshirës, që ofron mundësi të barabarta për të gjithë, duke respektuar, njëherazi, dallimet vetjake.<br>Programi Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" është në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Strategjinë Kombëtare të Arsimit, Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës dhe të gjithë bazën ligjore e nënligjore që është në fuqi[3] [4] [5] [6] [7]. Ky program ka në qendër nevojat dhe interesat e studentëve, duke qenë një sistem ku dijet e fushave të nxënies dhe kompetencat e ndërtuara nga studentët prodhojnë zgjidhje për problemet jetësore dhe sjellin përfitime për atë dhe për shoqërinë, sistem që vlerëson forcën e diversitetit kulturor e gjuhësor dhe të teknologjive të kohës, për t'i përgatitur studentët të përballen me vetëbesim me sfidat e mjedisit global, sistem ku të gjithë aftësohen të nxënë gjatë gjithë jetës[8]. Në këtë mënyrë, programi kontribuon në vlerat e "Cilësisë dhe Ekselencës", "Integritetit, Besimit dhe Respektit", "Kërkimit shkencor, Inovacionit dhe Kreativitetit" dhe "Idealet" duke kontribuar jo thjesht nga ana akademike por dhe ajo qytetare në të mirë të rajonit tonë[9]. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | *Po.* Programi Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" duke qenë në koherencë me misionin e UAMD[10], synon në mënyrë të vazhdueshme arritjen e standardeve akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet e cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë. Qëllimi i progamit të studimit |

[1]Evidencë 1_Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, 2015
[2]Evidencë 2_ Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025
[3]Evidencë 1_Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, 2015
[4]Evidencë 6 _Strategjia Kombëtare e Arsimit, 2021-2026
[5]Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
[6]Evidencë 7_Strategjia Kombëtare për Teknologjinë, Shkencën dhe Inovacionin 2017-2022
[7] Evidencë 8_Draft Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin, 2023-2030
[8]Evidencë 1_Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, 2015
[9]Evidencë 4_ Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025
[10]Evidencë 4_ Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025

| | |
|---|---|
| | është "Studenti në Qendër", e cilësuar edhe në Plani i Zhvillimit Strategjik të Institucionit[11]. Vetë Universiteti, dhe Fakulteti i Biznesit si njësi e tij, synon nxitjen dhe zhvillimin e të menduarit kritik e analitik, ruajtjen e të dhënave personale[12] si dhe ndjenjës së përgjegjësisë dhe angazhimit ndaj njeriut, komunitetit, kulturave, ngjarjeve e çështjeve të ndryshme që shqetësojnë individin dhe komunitetin, mbështetur në qëllimin e vetë UAMD-së[13] dhe qëllimin e programit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"[14], e shprehur kjo edhe nga Mendimi i Dekanit[15]. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit. | ***Po.*** Programi Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" është hartuar në përputhje me strategjinë e UAMD-së[16]. Institucioni thekson rëndësinë e rritjes cilësore të programit të studimit në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit duke ju referuar misionit në Planin e Zhvillimit Strategjik të UAMD-së[17]. Ky program plotëson nevojat e tregut si një përzierje unike në fushën e sigurimit, menaxhimit të rrezikut dhe shërbimeve financiare, sikurse i jep hapësirë studentëve të përparojnë në kërkimin shkencor. Gjithashtu programi i studimit synon të formojë ekspertë dhe specialistë të aftë në Industrinë e Sigurimeve dhe sektorin e Menaxhimit të Rrezikut, si edhe studiues shkencorë për problematikat dhe institucionet mbikqyrëse të kësaj Industrie, të pajisur me kualifikimin e duhur sipas standardeve ndërkombëtare për kërkim e zhvillim të tregut si dhe për të rritur integrimin e industrisë së sigurimeve në kornizat e ekonomisë së tregut sipas BE. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. | ***Po.*** Programi Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit të UAMD[18 19] në nivel institucioni dhe njësive përbërëse të tij[20 21]. Këto plane strategjike, janë në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit, duke u reflektuar në mënyrë periodike në përmirësime të planeve mësimore, programeve të lëndëve, por edhe duke paraqitur ndryshimet në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit[22], në përputhje me trendet ndërkombëtare. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi I.2** |
|---|
| **Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë** |

[11]Evidencë 4_ Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025
[12]Evidencë 10_Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UAMD
[13]Evidencë 4_ Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025
[14]Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut
[15]Evidencë 5_Mendimi i Dekanit
[16]Evidencë 4_ Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025
[17]Evidencë 4_ Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025
[18]Evidenca 3_ Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2016-2020
[19]Evidencë 4_ Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025
[20]Evidencë 11_Plani Strategjik, Fakulteti i Biznesit, 2021-2025
[21]Evidencë 12_Plani Strategjik, Departamenti Financë - Kontabilitet, 2021-2025
[22] Evidencë 8_Draft Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin, 2023-2030

| përgjegjëse për programin e studimit në institucion. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | *Po.* Fakulteti i Biznesit si pjesë e Universitetit "Aleksandër Moisiu" zbaton Statutin e Universitetit, kreu II, neni 8[23], i cili është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përshtatje me misionin dhe objektivat e tij. Programi i studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" ofrohet nga Departamenti i Financë Kontabilitetit i cili është i përbërë nga 16 anëtarë[24] të kualifikuar ndër vite, me një background të pasuruar në fushën e financës dhe kontabilitetit pasqyruar në CV-të[25] e tyre dhe në Dosjet e Vetëvlerësimit[26], nga një staf me lektorë me kohë të pjesshme[27] ekspert të fushave që trajton ky program studimi dhe nga personeli akademik[28] i departamenteve të tjerë të Fakultetit të Biznesit. Departamenti i Financë Kontabilitetit ofron 7 programe studimi të shpërndara në tre cikle studimi[29]. |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | *Po.* Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore sipas Vendimit Nr. 310, datë 11.05.2022 mbi "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"[30], si dhe Udhëzimit Nr.31, datë 15.11.2022, Nr.7556/1 Prot. mbi "Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"[31], dhe me vendim për klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane nën emërtimin 72MS0412S[32]. |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | *Po.* Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit sipas fushave kërkimore shkencore për departamentin e Financë Kontabilitetit[33]. |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni | **NA** |

[23]Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
[24]Evidencë 16_Kualifikimi dhe kërkimi shkencor i PAE në 5 vitet e fundit
[25]Evidencë17_CV-të e lektorëve, Programi Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
[26]Evidencë 19_Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Departamentit të Financë Kontabilitetit
[27]Evidencë 17.1_CV-të PAK, Programi Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut, v.a 2021-2022
[28]Evidencë 17.1_CV-të PAK, Programi Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut, v.a 2021-2022
[29]Evidencë 22_Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Financë Kontabilitetit
[30]Evidencë 23_Vendimit Nr. 310, datë 11.05.2022 mbi "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
[31]Evidencë 24_Udhëzimit Nr.31, datë 15.11.2022, Nr.7556/1 Prot. mbi "Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
[32]Evidencë 25_Kodifikimet e programeve të studimit në departamentin Financë Kontabilitet
[33]Evidencë 26_ Fushat kërkimore shkencore në departamentin e Financë Kontabilitetit

| | |
|---|---|
| ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | *Po.* Institucioni jep mundësi studentëve të informohen për mundësitë e punësimit, internshipeve, trajnimeve të ndryshme sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit në rang Universiteti dhe Fakulteti, sic është program coursera ku studentëve të UAMD ju dha mundësia të zhvillonin një kurs falas[34]. Të gjitha këto mundësi promovohen në faqen zyrtare të UAMD[35], rrjetet sociale të Departamentit të Financë Kontabilitetit/Fakultetit të Biznesit[36] dhe emaile-ve sipas programeve të studimit[37]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi I.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | *Po.* Sipas nenit 57 dhe 58 në Ligji për Arsimin e lartë, 2015[38]; nenit 51 Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës[39]; neni 24 i Rregullores së Fakultetit të Biznesit[40], dhe neni 17 i Rregullores së Departamentit Financë Kontabilitetit[41], përcaktohen detyrat e personelit akademik dhe statusi i tyre. Gjithashtu, detyrat dhe përgjegjësi të tjera respektive janë të përcaktuara në marrëveshjet e firmosura midis drejtuesit të departamentit dhe anëtarëve të departamentit, në cdo fillim viti[42]. Institucioni siguron gjithmonë bashkëpunime mes njësive të personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Duke u bazuar në nenin 10 të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë[43]; kreu V, neni 109 në Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" |

[34]Evidencë 163_Kurse online me Coursera_UAMD
Evidencë 27_Marrëveshjet e bashkëpunimit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës dhe Fakultetit të Biznesit
[35]https:// www.facebook.com/NeJemiUAMD/
https:// www.facebook.com/uamdofficial/
[36]https://www.facebook.com/Departamenti-Financ%C3%AB-Kontabilitetit-UAMD-464126980595934/
https:// www.facebook.com/AlumniNetwork-FB-uamd-100711372188813/
[37]Evidencë 198_Njoftim punësimi për studentët
[38]Evidencë 1_Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, 2015
[39]Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
[40]Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[41]Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet
[42]Evidencë 29_Marrëveshjet për organizimin e kohës vjetore të punës për stafin akademik të departamentit Financë Kontabilitet, v.a 2022-2023
[43]Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë

| | |
|---|---|
| | Durrës[44], neni 24 në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit[45] dhe kreu IV, neni 17 në Rregulloren e Departamentit Financë Kontabilitetit[46], janë përcaktuar detyrat e kordinatorëve të programeve të studimit dhe personelit akademik nëpërmjet marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Komunikimi i ndarjes së detyrave realizohet në mbledhjet e organizuara në departament, takimeve me grupet e punës dhe emaile-ve[47]. Analiza e vazhdueshme e tyre bëhet nëpërmjet raporteve të ndryshme si, Analiza Vjetore e Departamentit të Financë Kontabilitetit[48], Analiza e Ecurisë së programit të studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"[49] dhe Dosjeve të Vetëvlerësimit[50]. |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | ***Po.*** Njësia bazë në bashkëpunim me njësinë kryesore për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të rëndësishme në vend publike dhe private referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel Universiteti[51] dhe Fakulteti[52]. Institucioni mundëson leksione të hapura nga lektorë apo përfaqësues nga institucione të rëndësishme[53]. Gjithashtu studentët nën udhëheqjen e lektorëve marrin pjesë në konkurse të ndryshme, në konferencën e AMF dhe Bursën private të Tiranës (ALSE) referuar aktiviteteve të mbajtura në fakultet dhe departament[54]. Paralelisht Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me programet e Bashkimit Europian të trajnimit dhe mobilitetit të stafit akademik[55], dhe të studentëve[56]. |
| **Kriteri 3.** Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe | ***Po.*** Institucioni ka nënshkruar marrëveshje të posacme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve[57] [58]. Institucioni do të vazhdoj bashkëpunimin në bazë të kërkesave të tregut dhe në përputhje me Strategjitë për Zhvillimin Kombëtar[59], duke realizuar edhe përmirësimin e kurrikulave sipas nevojave. Qëllimi kryesor në tërësi është pasurimi dhe përmirësimi i ofertës akademike dhe intensifikimi i kërkimit shkencor në kuadër të kontributit për zhvillimin e vendit. Programi i studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" ka shfrytëzuar marrëveshjet e realizuara për: |

[44]Evidenca 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës
[45]Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[46]Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet
[47]Evidencë 18_Korrespondenca midis Përgjegjësit të departamentit dhe Koordinatorit të MSC ISDR
[48]Evidencë 32_Analiza Vjetore e departamentit Financë Kontabilitet v.a 2021-2022
[49]Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc ISDR
[50]Evidencë 19_Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Departamentit të Financë Kontabilitetit
[51]Evidencë 33_Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel Institucioni
[52]Evidencë 35_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit me bizneset
[53]Evidencë 36_Leksionet e hapura dhe aktivitetet e Departamentit Financë Kontabilitetit, v.a 2021-2022
[54]https://www.facebook.com/profile.php?id=100045245540366
https://www.facebook.com/NeJemiUAMD
[55] Evidencë 37_Trajnime dhe mobilitete Erasmus +, PAE, v.a 2017-2022
[56]Evidencë 38_ Pjesëmarrjet në programet Easmus + për studentët, v.a 2017-2022
[57]Evidencë 37_Trajnime dhe mobilitete Erasmus +, PAE, v.a 2017-2022
[58] Evidencë 38_ Pjesëmarrjet në programet Easmus + për studentët, v.a 2017-2022
[59] Evidencë 8_Draft Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin, 2023-2030

| | |
|---|---|
| mobilitetit të personelit akademikdhe studentëve. | - Të mësuarit përmes të bërit (praktikave profesionale);<br>- Ofrimin e praktikave bashkëkohore dhe ndërkombëtare në fushën e sigurimeve dhe rrezikut (Trajnime/Leksione të hapura/Konkurse);<br>- Ndërlidhja e programit me tregun e punë, si pjesëmarrja e Shoqërive të Sigurimit dhe bankave tregtare (Panairi Vjetor i Punës)[60];<br>- Nxitjen e të rinjve në thellimin e kërkimeve shkencore përmes aksesit të lirë dhe projekteve/konkurseve të përbashkëta;<br>- Arsimim dhe përvojën ndërkombëtare (studime semestrale Erasmus+, trajnime, mësimdhënie e PAE jashtë vendit);<br>- Zhvillimin e projekteve të përbashkëta ku studenti të jetë aktori kryesor.[61] [62] [63] [64] [65] [66] [67] [68] [69] |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | *Po.* Institucioni dhe në mënyrë specifike njësia përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" periodikisht ka hartuar raporte analitike për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit[70]. Kjo është vënë re edhe nga gatishmëria e kompanive të ndryshme që Institucioni ka marrëveshje për të bërë vizita në kompani, internshipe, leksione të hapura dhe praktika profesionale[71]. Por nga ana tjetër programi i studimit MSc ISDR ka qenë burim i mirë njerëzor për kompanitë e sigurimit dhe institucionet bankare dhe të tjera institucione, referuar analizës së ecurisë së programit të studimit[72] [73] [74]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës i** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

[60] Evidencë 55_Aktivitete Fakulteti i Biznesit
[61] Evidencë 200_Autorizim për paktikën mësimore_Maste
[62] Evidencë 36_Leksionet e hapura dhe aktivitetet e Departamentit Financë Kontabilitet, v.a 2021-2022
[63] Evidencë 37_Trajnime dhe mobilitete Erasmus +, PAE, v.a 2017-2022
[64] Evidencë 38_Pjesëmarrjet në programet Erasmus + për studentët, v.a 2017-2022
[65] Evidencë 40_Abonim në librarinë digjitale JSTOR në kuadër të marrëveshjes ndërmjet UAMD-së dhe AADF
[66] Evidencë 41_Lista E-books e disponueshme
[67] Evidencë 42_Informacion për Bibliotekën Online
[68] Evidencë 43_Konkursi Kombëtar i Punimeve Kërkimore
[69] Evidencë 94_Komunikim email_Njoftim mbi internshipe
[70] Evidencë 45_Analiza e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me Departamenti Financë Kontabilitet, v.a 2022-2023
[71] Evidencë 35_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit me bizneset
[72] Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc ISDR
[73] Evidencë 93_Analize e tregut të punës Msc ISDR
[74] Evidenca 45_Analiza e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Departamentin Financë Kontabilitet, v.a 2022-2023

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

| Standardi II.1<br>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | *Po.* Organizimi i programit të studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" organizohet në lëndë ose module të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) mbështetur në pikën 2, VKM Nr. 41, datë 24.1.2018[75], mbështetur tek pika 4 dhe 6 e Riorganizimit të programit të studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"[76], në përputhje me Udhëzimin nr. 31, datë 29/12/2017[77]. Totali i Krediteve (ECTS) është120 ECTS. Kohëzgjatja normale është 2 vite, forma e studimit me kohë të plotë, bazuar në suplementin e diplomës të MSc ISDR[78] dhe Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut[79]. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | *Po.* Programi i studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" synon të ndihmojë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh mbështetur në Analizën e tregut të punës[80] dhe mbështetur në pikën 6 të Riorganizimit të programit të studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut[81]. Ky program studimi ka objektiva plotësisht të qarta duke krijuar baza të qëndrueshme njohurish për studime të mëtejshme, si, doktorale. Rritja e kompetencave profesionale është ndër elementët kryesorë në këtë program studimi. Përdorimi i literaturave të viteve të fundit, kërkimeve shkencore, rasteve studimore, të cilat realizohen nga përmirësimi i vazhdueshëm i syllabus-eve[82], aktiviteteve dhe leksioneve të hapura[83]. Gjithashtu për tju përshtatur diversitetit të kërkesave të studentëve, lektorët sjellin metoda nga më inovativet të ofruara tek studentët e programit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"[84] me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm.<br>Sipas kuadrit të përgjithshëm formues të programit të studimit gjatë tre semestrave studentët orientohen përmes lëndëve bazë të detyrueshme duke i gërshetuar me lëndët karakterizuese, dhe lëndëve të tjera ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose |

[75] Evidencë 60_VKM nr. 41, datë 24.1.2018
[76] Evidencë 51_Riorganizimi i MSC ISDR v.a 2018-2019; Evidencë 49.2_Riorganizim Master nën 20%, 2021-2022; Evidencë 49.1_Riorganizim Master nën 20%, 2022-2023; Evidencë 49_Riorganizimi Master FB 2021-2022 vendim senati
[77] Evidencë 50_Udhëzimi nr. 31, datë.29.12.2017
[78] Evidencë 68_Suplement i Ri Msc ISDR
[79] Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut
[80] Evidencë 93_Analizë e tregut të punës Msc ISDR
[81] Evidencë 51_Riorganizimi i MSC ISDR v.a 2018-2019
[82] Evidencë 108_Syllabuse_sem 2_v.a. 2021-2022
[83] Evidencë 55_Aktivitete Fakulteti i Biznesit
[84] Evidencë 66_Metodat interaktive të përdorura për mësimdhënie përfundimtare, shkurt 2023

| | |
|---|---|
| | integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje, ku njëkohësisht i jepet rëndësi edhe lëndëve plotësuese. Në semestrin e fundit të programit të studimit studentët realizojnë praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta të nënshkruara nga Fakulteti dhe Departamenti[85] për këtë qëllim. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | ***Po.*** Programi i studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" parashikon ngarkesën në kredite të përcaktuar për praktikën profesionale, me ekuivalentim sipas VKM 41, pika 2.4 dhe 2.5[86] [87], Udhëzim nr. 31 datë 29.12.2017[88] për "Përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë "[89] dhe mbështetur në planet mësimore dhe kurrikulat e ndryshuara në vitin akademik 2022-2023[90]. |
| **Kriteri 4.** Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit. | **NA** |
| **Kriteri 5.** Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme. | **NA** |
| **Kriteri 6.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | **NA** |

[85] Evidencë 45_Analiza e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me Departamenti Financë Kontabilitet, v.a 2022-2023
[86] Evidencë 60_VKM Nr. 41 datë 24.1.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
[87] Evidencë 79_VKM nr.879, datë 18.12.2019 Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41 date 24.01.2018
[88] Evidencë 77_Udhëzim Nr.31, datë 29.12.2017
[89] Evidencë 51_Riorganizimi i MSC ISDR v.a 2018-2019
[90] Evidencë 49.1_Riorganizim Master nën 20%, 2022-2023

| | |
|---|---|
| **Kriteri 7.** Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | *Jo.* Programi i studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut", referuar emertesës nuk ka ngjashmëri në emërtese me programe të tjera të ngjashme[91]. Referuar kodifikimit të ri 72MS0412S[92] të bërë në vitin 2022, nuk kemi informacion mbi kodifikimin e programeve të tjera të ngjashme të studimit. |
| **Kriteri 8.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | *Po.* Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore sipas Vendimit Nr. 310, datë 11.05.2022 mbi "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"[93] si dhe Udhëzimit Nr.31, datë 15.11.2022, Nr.7556/1 Prot. mbi "Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"[94], dhe me vendim klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane nën emërtimin 72MS0412S[95]. |
| **Kriteri 9.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | **NA** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike | *Po.* Departamenti Financë-Kontabilitet është përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" dhe i përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore sipas nenit 25, të Ligjit 80/2015[96] për organizimin dhe strukturën akademike sipas pikës 5 të Riorganizimi i programit të studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" (v.a 2018-2019)[97] dhe riorganizimit nën |

[91] Evidencë 21_Kurrikula të ngjashme me IAL të tjera
[92] Evidencë 25_ Kodifikimet e programeve të studimit të ofruara nga Departamenti Financë Kontabilitet
[93] Evidencë 23_Vendimit Nr. 310, datë 11.05.2022 mbi "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
[94] Evidencë 24_Udhëzimit Nr.31, datë 15.11.2022, Nr.7556/1 Prot. mbi "Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
[95] Evidencë 25_ Kodifikimet e programeve të studimit të ofruara nga Departamenti Financë Kontabilitet
[96] Evidencë 1_Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, 2015
[97] Evidencë 51_Riorganizimi i MSC ISDR v.a 2018-2019

| | |
|---|---|
| vlerësimin dhe akreditimin. | 20% (v.a 2022-2023)[98]. Departamenti Financë-Kontabilitet ka bërë ndarjen e grupeve mësimore kërkimore shkencore[99]. Gjithashtu Departamenti Financë-Kontabilitet ka përcaktuar Koordinatorët e programeve të studimit[100] dhe përcaktimin e Koordinatorit për Kërkimin Shkencor[101]. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | *Po.* Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për programin e studimit, ku angazhon personel ndihmës akademik/administrativ për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" duke u mbështetur në rregulloren e departamentit të Financë Kontabilitetit[102] dhe Rregulloren e Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"[103]. Krahas koordinatorit të programit dhe Drejtuesit të njësisë bazë, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen e programit, Njësia Kryesore mbështet edhe në stafin akademik në zhvillimin e programit përmes asistentes së Departamentit Financë Kontabilitet, sekretarisë mësimore dhe laborantëve. |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | *Po.* Njësia Bazë dhe Njësia Kryesore janë përgjegjës për çdo program studimi, ku dhe është caktuar një Koordinator për secilin program studimi[104]. Përgjegjësitë e koordinatorit për programin e studimit janë të përcaktuara në përputhje legjislacionin në fuqi[105] [106] dhe aktet e tjera institucionale[107] [108]. Kordinatori mban kontakte të vazhdueshme me drejtuesin e Njësisë Bazë për lajmërime dhe për orientime të studentëve në lidhje me programin dhe praktikat profesionale[109]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon | *Po.* Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë MSc ISDR, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Gjithë informacioni për |

98 Evidencë 49.1_Riorganizim Master nën 20%, 2022-2023
99 Evidencë 199_Ngritja e grupeve mësimore kërkimore dhe lektorët e Departamentit FK
100 Evidencë 53 _Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit
101 Evidencë 56_Vendimi i përcaktimit të kordinatorit të kërkimit shkencor
102 Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet
103 Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit
104 Evidencë 53 _Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit
105 Evidencë 78_VKM Nr.824, datë 24.12.2021 Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë
106 Evidencë 76_Udhëzimi nr. 27 datë 29.12.2017
107 Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
108 Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet
109 Evidencë 18_Korrespondenca midis Përgjegjësit të departamentit dhe Koordinatorit të MSC ISDR

| | |
|---|---|
| informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | programin MSc ISDR qarkullon dhe arkivohet në mbështetje të Rregullores për Qarkullimin dhe Arkivimin e Dokumentacionit të Brendshëm në UAMD[110]. Po ashtu një informacion i përgjithshëm së bashku me kurrikulën dhe organizimin e programit është i publikuar në faqen zyrtare të universitetit[111]. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | ***Po.*** Përbërja e strukturës së programit të studimit MSc ISDR është përcaktuar në akte ligjore e nënligjore të VKM nr. 41, pika 2.4 dhe 2.5[112] [113]dhe Udhëzimit nr. 31, datë 29.12.2017 për "Riorganizimin e Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" viti akademik 2018-2019, pikat 4 dhe 6 [114] dhe riorganizimit nën 20% në v.a 2022-2023. Programi i studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" përmban planin mësimor, ku përfshihen ndarjet e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore[115] të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | ***Po.*** Programi i studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike[116] të pranimit, transferimit[117] dhe ekuivalentimit [118] të studimeve. Institucioni bën njohjen e lëndëve sipas nenin 39, pika 4 dhe nenit 47 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit[119] dhe vendimeve të shpallura nga Fakulteti i Biznesit mbi transferimet[120]. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | ***Po.*** Programi i studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" i përmban të gjitha informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, seminaret, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara sipas nenit 53 të rregullores së Fakultetit të Biznesit[121]. Përbërja e strukturës së programit të studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" dhe hartimi i syllabuseve është përcaktuar në akte ligjore e nënligjore të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018[122] dhe Udhëzim nr. 31, datë 29.12.2017[123] për "Riorganizimit të programit të studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut", viti 2018, dhe riorganizimin në vitin 2022-2023[124]. |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit | ***Po.*** Programi i studimit MSc ISDR është hapur në vitin akademik 2012-2013, |

[110]Evidencë 47_ Rregullore për Qarkullimin dhe Arshivimin e Dokumentacionit të Brendshëm në UAMD
[111]https://uamd.edu.al/msc-industria-e-sigurimeve-dhe-drejtimi-i-rrezikut/
[112] Evidencë 60_VKM nr.41 datë 24.1.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
[113] Evidencë 79_VKM nr.879, datë 18.12.2019 Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41 date 24.01.2018
[114] Evidencë 51_Riorganizimi i MSC ISDR v.a 2018-2019
Evidencë 49.1_Riorganizim Master nën 20%, 2022-2023
[115]Evidencë 69_Ngarkesa mësimore Departamenti Financë Kontabilitet, v.a 2019-2022
[116]Evidencë 58_Kriteret e transferimeve për departamentin e Financë Kontabilitetit
[117]Evidencë 63_Komision Ad Hoc per transferim (Kriteret e transferimit) Vendim Nr. 14 datë 04.09.2020
[118]Evidencë 68_Suplement i Ri Msc ISDR
[119]Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[120]Evidencë 34_Shkresë për listën fituese të studentë për transferim studimesh
[121]Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[122] Evidencë 60_VKM nr.41 datë 24.1.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
[123]Evidencë 77_Udhëzim Nr.31, datë 29.12.2017
[124]Evidencë 49.1_Riorganizim Master nën 20%, 2022-2023

| | |
|---|---|
| të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | me një periudhë ndërprerjeje në v.a. 2018-2019, dhe nga v.a. 2019-2020 vazhdon rregullisht të jetë i hapur[125]. Me riorganizimin e vitit akademik 2018-2019, syllabuset e programit të studimit janë pasuruar me fjalët kyce, çdo temë ka sqarimet e objektivave dhe synimeve kryesore[126]. Literatura dhe përmbajtja e programit të studimit janë në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë[127].<br>Në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit të ofruar nga Fakulteti i Biznesit, syllabuset e lëndëve dhe të moduleve të ofruara nga programi i studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" janë përkthyer dhe arkivuar edhe në anglisht[128]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | *Po.* Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve janë të pasqyruara në VKM nr.41, pika 2.4 dhe 2.5[129 130] dhe Udhëzimin nr. 31, datë 29.12.2017 për Riorganizimin e programit të studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut", viti akademik 2018-2019, pikat 4 dhe 6[131], dhe riorganizimin nën 20% i v.a. 2022-2023[132]. Bazuar në planin mësimor, lëndët bazë të detyrueshme janë lëndët që i ofrojnë studentit të MSc ISDR njohuri dhe përgatitje metodologjike të përgjithshme. Lëndët karakterizuese, lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij. Lëndët ndërdisiplinore dhe/ose integruese janë të mbështetura kryesisht tek lëndë të financës dhe sigurimeve. Lëndët plotësuese janë të fokusuara në përfitimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatikës dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese. Gjithashtu ky program studimi ka të përfshirë praktikën profesionale, të cilën studentët mund ta zhvillojnë pranë subjekteve |

125 Evidencë 20_Urdhër Nr. 282, datë 04.07.2013, Urdhër për hapjen e programit të studimit MSc ISDR
126 Evidenca 19_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite_Model
127 Evidencë 49.1_Riorganizim Master nën 20%, 2022-2023
128 Evidencë 52_Model Syllabus-i në anglisht MSc ISDR
129 Evidencë 60_VKM nr.41 datë 24.1.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
130 Evidencë 79_VKM nr.879, datë 18.12.2019 Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41 date 24.01.2018
131 Evidencë 51_Riorganizimi i MSC ISDR v.a 2018-2019
132 Evidencë 49_Riorganizimi Master FB 2021-2022 vendim senati

| | |
|---|---|
| | publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim[133]. Pesha specifike që zë secila kategori e veprimtarive formuese brenda programit të studimit është e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi[134]. |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | *Po.* Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. Lëndët janë shpërndarë në semestra, në fillim lëndët bazë, pastaj lëndët formuese duke mos bërë më shumë se 25 orë në javë bazuar në kurrikulën e MSc ISDR[135]. Programi i studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" është hartuar në përputhje me akte ligjore e nënligjore të VKM-së nr. 41[136] dhe VKM nr. 879[137] dhe reflektuar në Udhëzimin nr. 31, datë 29.12.2017[138] për Riorganizimin e Programit të studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut", v.a 2018[139] dhe riorganizimet nën 20% të tjera në vazhdim. |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | **NA** |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | *Po.* Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitetet dhe punësim në përfundim të studimeve, mbështetur në dosjen e riorganizimit të programit MSc ISDR, e cila është konform bazës ligjore. Ky program studimi ofron një ndërthurje mes formimit teorik dhe atij praktik referuar kurrikulës së MSc ISDR[140]. Gjithashtu, studentët e këtij programi i kanë të gjitha mundësitë që të jenë pjesë e mobiliteteve duke qënë se veprimtaria formuese është e ngjashme me programe të tjera të ngjashme në universitetet e huaja[141]. Praktika gjatë detyrimeve përmbyllëse i jep mundësi studentëve të punësohen, duke ju përmbajtur statistikave referuar analizës së ecurisë së programit të studimit[142], ku rezultojnë që ato janë të punësuar gjatë gjithë ndjekjes së studimeve në Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" (referuar pyetësorit pas diplomimit të studentëve)[143]. |

[133]Evidencë 35_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit me bizneset
[134] Evidencë 79_VKM nr.879, datë 18.12.2019 Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41 date 24.01.2018
[135]Evidencë 49.1_Riorganizim Master nën 20%, 2022-2023
[136]Evidencë 60_VKM nr.41 datë 24.1.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
[137]Evidencë 79_VKM nr.879, datë 18.12.2019 Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41 date 24.01.2018
[138]Evidencë 50_Udhëzimi nr. 31, datë.29.12.2017
[139] Evidencë 51_Riorganizimi i MSC ISDR v.a 2018-2019
[140]Evidencë 49.1_Riorganizim Master nën 20%, 2022-2023
[141]Evidencë 21_Kurrikula të ngjashme me IAL të tjera
[142]Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc ISDR
[143]Evidencë 74_Pyetësor Vlerësimi i studentëve pas përfundimit të studimeve në BsC MsC MP

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | *Po.* Programet e lëndëve/moduleve të programit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në mbledhjet e departamentit[144] duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Gjithashtu departamenti i Financë-Kontanilitetit sipas nevojave të çdo anëtari të saj bën kërkesë bibliotekës për blerje të librave[145] në mënyrë që syllabus-et e lëndëve të përditësohen me literatura të 5 viteve të fundit. |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | *Po.* Përmbajtja e programit të studimit është e përcaktuar edhe në suplementin e diplomës Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"[146], rezultatet e pritshme të të nxënit po ti referohemi koncepteve të fituara nga lëndët e zhvilluara (kurrikulës)[147] garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve, mbështetur në raportin e ecurisë së programit të studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"[148]. |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | *Po.* Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës referuar dhe përshkrimit të Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"[149]. Ky program studimi ka objektiva plotësisht të qarta duke krijuar baza të qëndrueshme njohurish për studimet të mëtejshme doktorale dhe në cdo institucion tjetër financiar bankar (drejtoria e riskut) dhe institucion jo-bankar (shoqëri sigurimi, fonde investimi, fonde pensionesh vullnetare)[150] [151]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më | *Po.* Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, njësia bazë konsultohet dhe merr parasysh Raportin e Analizës së Ecurisë së programit MSc ISDR[152], |

[144]Evidencë 178_Vendime në mbledhje departamenti 06.10.2022
[145]Evidencë 177_Email blerje librash
[146]Evidencë 68_Suplement i Ri Msc ISDR
[147]Evidencë 49.1_Riorganizim Master nën 20%, 2022-2023
[148]Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc ISDR
[149]Evidencë 71_Përshkrimi Program studimi MSc ISDR
[150]Evidencë 68_Suplement i Ri Msc ISDR
[151]Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc ISDR
[152]Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc ISDR

| | |
|---|---|
| mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | pyetësorët para dhe pas diplomimit të studentëve[153] [154], feedback-u nga Panairi i Punës dhe aktiviteteve të tjera nga institucione partnere[155]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | ***Po.*** Institucioni i Arsimit të Lartë garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje mbështetur në nenin 22, pika 1 e Rregullores së Fakultetit të Biznesit[156] për përbërjen e Komisioneve të përhershme të Njësisë Kryesore si dhe garanton që studentët të vlerësojnë proçesin akademik nëpërmjet pyetësorit drejtuar studentëve[157], në kuadër të përmirësimit të cilësisë së intitucionit (mundësuar nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë). Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë[158], ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm, neni 2 i Rregullorës së NJSBC[159]. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet me studentët e diplomuar nëpërmjet plotësimit të pyetësorit[160] ngritur nga Departamenti për të marrë një mendim rreth problematikave, sygjerimeve ndaj përmirësimit të programeve të studimit referuar rezultateve të pyetësorit si dhe Analizës së Ecurisë së Masteri Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"[161] në mënyrë që studentët të fitojnë njohuri të plota mbi programin e studimit. Institucioni është angazhuar maksimalisht në organizimin, mbështetjen dhe fuqizimin e rrjeteve Alumni që funksionojnë pranë saj, duke i përfshirë gjithnjë e më shumë Alumni-t në strukturat konsultuese e drejtuese të universitetit, si dhe duke i angazhuar në aktivitete/projekte zhvilluese të UAMD[162]. |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) | ***Po.*** Në bashkëpunim me institucionet publike e private[163], Departamenti Financë Kontabilitet përshtat dhe riorganizon programin e studimit në përputhje me kërkesat dhe nevojat e institucioneve publike e private duke e pasuruar programin me leksione të hapura në fushën e sigurimeve, fondeve të sigurimit dhe pensioneve private"[164] dhe marrjes së mendimit të eksperteve të fushës[165]. |

[153]Evidencë 72_Pyetësor - Përzgjedhja e studimeve Bsc Master pranë UAMD
[154]Evidencë 74_Pyetësor Vlerësimi i studentëve pas përfundimit të studimeve në BsC MsC MP
[155]Evidencë 45_Analiza e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me Departamenti Financë Kontabilitet, v.a 2022-2023
[156]Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[157]Evidenca 132_Pyetësori i studentëve
[158]Evidencë 70_Ngritja e grupeve të GVB për proces Akreditimi
[159]Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[160]Evidencë 74_Pyetësor Vlerësimi i studentëve pas përfundimit të studimeve në BsC MsC MP
[161]Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc ISDR
[162]Evidencë 39_Alumni Network FB Raport
[163]Evidencë 35_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit me bizneset
[164] https://www.facebook.com/profile.php?id=100045245540366
[165]Evidencë 73_Pyetësor shpërndarë ekspertëve për përmirësimin e kurrikulave

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| dhe institucione publike e private. | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi II.6**<br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | ***Po.*** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit[166] dhe kërkimit shkencor[167]. Ky program studimi është në përputhje me Planin Strategjik të Fakultetit të Biznesit[168] dhe Planin Strategjik të Departamentit Financë Kontabilitet[169]. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | ***Po.*** Fakulteti i Biznesit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. Ky bashkërendim është përcaktuar dhe në marrëveshjet e personelit akademik me Drejtuesin e njësisë bazë[170]. Lektorët njihen me ndarjen e ngarkesës mësimore gjatë vitit[171] dhe në fillim të semestrave duke ju referuar kurrikulës dhe orarit zyrtar[172] që vjen në department. Në mënyrë të vazhdueshme sipas një kalendari të miratuar paraprakisht realizohen leksione të hapura ku ftohen personalitete të fushave të ndryshme, të cilët ndajnë eksperiencat dhe këshillat e tyre me lektorë dhe studentë[173]. Në varësi të ekspertizës së të ftuarve, ftohen edhe lektorët e departamenteve/fakulteteve të tjera për të marrë pjesë në to. Fakulteti dhe Departamenti nxit anëtarët e saj të marrin pjesë në Konferencën e Fakultetit të Biznesit dhe konferenca të tjera[174]. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | ***Po.*** Programi i studimit MSc ISDR nxit dhe motivon studentët të përfshihen në studime dhe projekte apo aktivitete kërkimore. Kjo realizohet nëpërmjet disa mënyrave, si pjesëmarrjet në konkurse[175]. Fakulteti i Biznesit, cdo vit realizon Konferencën Studentore dhe nxit studentët të marrin pjesë me punimet e tyre ose si dëgjues[176]. |

[166]Evidencë 71_Përshkrimi Program studimi MSc ISDR
[167]Evidencë 26_ Fushat kërkimore shkencore për departamentin e Financë Kontabilitetit
[168]Evidencë 11_Plani Strategjik, Fakulteti i Biznesit, 2021-2025
[169]Evidencë 12_Plani Strategjik, Departamenti Financë - Kontabilitet, 2021-2025
[170]Evidencë 29_Marrëveshjet për organizimin e kohës vjetore të punës për stafin akademik të departamentit Financë Kontabilitet, v.a 2022-2023
[171]Evidencë 69_Ngarkesa mësimore Departamenti Financë Kontabilitet, v.a 2019-2022
[172] Evidencë 187_Orari Mësimor Master ndër vite
[173]https://www.facebook.com/profile.php?id=100045245540366
[174]Evidenca 31_Emaile shkëmbimi për aktivitete shkencore-stafi akademik
[175]Evidencë 198_Njoftim punësimi për studentët
[176]https://nscbf.uamd.edu.al/
https://nscbf.uamd.edu.al/wp-login.php

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. | *Po.* Stafi akademik i UAMD inkurajohet që të hulumtojë dhe të publikojë në revista të indeksuara me Scopus duke i rimbursuar ato për tarifën e paguar[177]. Kjo formë e shpërblimit të akademikëve siguron një mekanizëm të përshtatshëm për të kontrolluar dhe inkurajuar veprimtarinë shkencore dhe botimet[178]. Aktivitetet shkencore dhe kërkimore kanë qenë pjesë e një procesi vlerësimi dhe financuar nga IAL[179]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi II.7**<br>**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | *Po.* Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor, ku përmendim projektin në fushën e sigurimeve[180] të miratuar në department, i cili është pjesë e Doktoraturës por që njëkohësisht është vlerë e shtuar në programin e studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut". |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | *Po.* Njësia bazë angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave, referuar lektorëve udhëheqës me të MSC ISDR të cilët mbikëqyrin punën e studentëve në fushën e sigurimeve dhe të riskut[181]. |
| **Kriteri 3.** Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. | *Po.* Fakulteti i Biznesit, cdo vit realizon Konferencën e Fakultetit ku marrin pjesë stafi akademik dhe Konferencën Studentore ku studentët mund të marrin pjesë me punimet e tyre ose si dëgjues. Këto konferenca ndihmojnë personelin akademik dhe studentët për arritjen e objektivave kërkimore shkencore[182] [183]. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit formon profesionistë konkurrues | *Po.* Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar duke ju referuar Raportit të Analizës së Ecurinë së Master i Shkencave |

[177]Evidencë 54_Rregullore për menaxhimin e aktiviteteve kërkimore shkencore
[178]Evidencë 61_Financim i botimeve të indeksuara me Scopus
[179]Evidencë 62.1_Thirrje për aplikim për projekte kërkimore shkencore 2022
Evidencë 57_Rregullorja e Mbajtjes së të dhënave për Kërkimin Shkencor
https://uamd.edu.al/shpallet-lista-e-projekteve-kerkimore-shkencore-fituese-ne-uamd/
[180]Evidencë 62_Formular projekt propozimi – Prof. Dr. Luljeta Kikino
[181]Evidencë 67_Model temë Diplome, studente MSc ISDR
[182]Evidencë 201_Vendim per grupet e punes ne Konferencen e FB, 2021-2022.
http://www.iscbf.org
[183]Evidencë 202_Vendim Dekanati Konferenca studentore 2020
https://nscbf.uamd.edu.al/wp-login.php

| | |
|---|---|
| për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. | "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut". Ky program nëpërmjet mobiliteteve ofron studentëve mundësinë që kurse të ndryshme t'i zhvillojnë në shtete të ndryshme[184] nëpërmjet Erasmus Mobility, duke rritur mundësitë e punës ndërkombëtarisht. Nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit[185], ky program studimi i ofron studentëve internshipe/praktika pune dhe mundësi punësimi në institucione me njësi në shtete të ndryshme[186]. |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës. | ***Po.*** Njësia Bazë ofron nëpërmjet këtij program studimi një kurrikul të pasur[187] për studentët që duan të jenë pjesë e profesionit të fushës së sigurimeve dhe riskut në institucione të ndryshme financiare si dhe i hap rrugë këtyre studentëve të marrin certifikime të ndryshme sipas tregut të punës. |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (*p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU*). | **NA** |

| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

[184]Evidencë 176_LA Arlinda Nerguti
[185]Evidencë 35_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit me bizneset
[186]Evidencë 94_Komunikim email_Njoftim mbi internshipe
[187]Evidencë 49.1_Riorganizim Master nën 20%, 2022-2023

# III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | *Po.* Duke u mbështetur në specifikat e organizimit të mësimdhënies në UAMD, orët e mësimit zhvillohen të pandara në leksione dhe seminare (ku në disa raste është i njëjti lektor që zhvillon si leksionet edhe seminaret) mbështetur në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"[188] si dhe në rregulloren e Fakultetit të Biznesit[189], Rregulloren e Departamentit Financë Kontabilitet[190]. Formatet kryesore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë të përcaktuara edhe në leksionet, punët laboratorike, detyrat e kursit, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar në Rregulloren e UAMD-së[191] në Nenin 60, pika 5[192]. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | *Po.* Programi i studimit MSc ISDR ofron një kurrikul të pasur me lëndë/module, të cilat janë në përputhje me natyrën dhe fushën e studimit. Personeli akademik respekton dhe i përgjigjet nevojave të studentëve duke ofruar metoda të ndryshme inovative mësimdhënie dhe mësimnxënie[193].<br>Gjatë zhvillimit të lëndëve të programit të studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut", gjithashtu përdoren metoda të ndryshme, duke përfshirë leksionet e hapura, leksione të caktuara në laborator, seancat e ushtrimeve dhe diskutimeve, si dhe prezantimi e diskutimi i projekteve në grup. Duhet theksuar që gjatë vitit akademik 2020-2021 si pasojë e Pandëmisë, procesi mësimor është zhvilluar përmes klasave online duke përdorur platformat Teams, Classroom, Moodle. Institucioni ka mundësuar gjatë kësaj kohe trajnime[194] për përdorimin e këtyre platformave për stafin akademik dhe manuale përdorimi për studentët. Njësia bazë ka monitoruar mësimin online përmes raportimeve me formularët përkatës për secilin lektor[195]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | *Po.* Universiteti "Aleksandër Moisiu" ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme[196] duke mbështetur stafin akademik të aplikojë për mobilitete trajnimi apo mësimdhënie në Universitete të ndryshme. Këto trajnime dhe eksperienca kanë ndihmuar në përmirësimin e aftësive didaktive duke sjellë një frymë të re në Departament[197]. Fakulteti i Biznesit nxit |

[188]Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut
[189]Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[190]Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet
[191]Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës
[192]Evidenca 39_Përmbledhëse e Metodave interaktive të përdorura për mësimdhënie
[193]Evidenca 39_Përmbledhëse e Metodave interaktive të përdorura për mësimdhënie
[194]Evidencë 90.1_Trajnim për mësimin online_Moodle
[195]Evidencë 90_Raport monitorimi të mësimit online Rezultate Teams
[196]Evidencë 33_Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel institucioni
[197]Evidencë 37_Trajnime dhe mobilitete Erasmus +, PAE, v.a 2017-2022

| | |
|---|---|
| | përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimit të kompetencave didaktike[198] si realizimi i mësimdhënies në laborator, testimi në laborator, përdorimi i apikacioneve online classroom apo teams për projektet dhe pyetje të tjera. Departamenti mbështetet nga Fakulteti i Biznesit dhe Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës për aktivitete të ndryshme në bashkëpunim me përfaqësues biznesesh dhe institucionesh financiare[199]. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.<br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | ***Po.*** Personeli akademik mban grada dhe tituj shkencor të fituar brenda dhe jashtë vendit[200] i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" ka eksperiencë shumëvjecare dhe me përvojë mësimdhënie si në universitetet shtetërore ashtu edhe ato private[201]. Qëllimi kryesor i mësimdhënies është që të nxiten studentët që të japin mendimin e tyre individual duke i angazhuar në projekte individuale, si dhe motivimi që realizohet për pjesëmarrjen e tyre në konferenca studentore[202], konkurse të ndryshme të organizuara nga AMF (Loja e Bursës), AADF (konkursi i paper-it më të mirë), apo pjesëmarrje në projekte të ndryshme në institucione të tjera[203]. |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | ***Po.*** Departamenti i Financë-Kontabilitetit në analizat vjetore[204] të tij vlerëson përputhjen e metodave të përdorura të mësimdhënies me objektivat formuese. Për çdo vit studentëve i drejtohet një pyetësor ku vlerësojnë format e përdorura nga lektorët në auditor dhe më pas sygjerimet e tyre reflektohen në department[205]. Mënyrat dhe format e mësimdhënies të përdoruara në programin e studimit MSc ISDR janë të shprehura në nenin 51, pika 5 e Rregullores së Fakultetit të Biznesit[206] dhe në nenin 12 të Rregullores e MSc ISDR[207]. Rritja e mundësive të praktikave për studentët e masterit nëpërmjet rritjes së numrit të bashkëpunimeve me bizneset. Përfshirja e tyre në këshillimin dhe karrierën, rritja e mundësive për klube studentore, përfshirja në aktivitete trajnuese si dhe mundësi për leksione të hapura[208]. |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në | ***Po.*** Në Universitetin "Aleksandër Moisiu" për të rritur dhe garantuar cilësinë e mësimdhënies është ngritur Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, aktiviteti i së cilës është i mbështetur në rregulloren e kësaj njësie[209]. Universiteti "Aleksandër Moisiu" mbështet dhe nxit përdorimin dhe promovimin e metodave të reja inovative[210] në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies. Universiteti dhe njësitë përgjegjëse angazhohen që të trajnojnë |

[198]Evidencë 178_Vendime ne mbledhje departamenti 06.10.2022
[199] Evidenca 35_Buletini i aktiviteteve në FB – për tu shtuar sapo te jete gati
[200]Evidencë 19_Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Departamentit të Financë Kontabilitetit
[201]Evidencë 96_ Departamenti Financë-Kontabilitet - Titujt dhe Gradat në vitet 2018-2023
[202]Evidenca 105_Konferenca Studentore e organizuar nga FB
[203]Evidenca 106_Njoftime për aktivitete, metodologjia
[204]Evidencë 32_Analiza Vjetore e departamentit Financë Kontabilitet v.a 2021-2022
[205]Evidencë 74_Pyetësor Vlerësimi i studentëve pas përfundimit të studimeve në BsC MsC MP
[206]Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[207] Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut
[208]Evidencë 55_Aktivitete Fakulteti i Biznesit
[209]Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[210]Evidenca 39_Përmbledhëse e Metodave interaktive të përdorura për mësimdhënie

| | |
|---|---|
| kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies[211] dhe implementimin e metodave të reja nëpërmjet angazhimit të personelit në mobilitete në kuadër të programeve Erasmus +[212]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | *Po.* Vlerësimi i njohurive në Universitetin "Aleksandër Moisiu" dhe në Fakultetin e Biznesit është specifikuar në Rregulloren e UAMD-së[213] në nenin 68, pika 1-6, si dhe në nenin 14 të Rregullores së programit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"[214], Rregulloren e Fakultetit të Biznesit[215] në nenin 59, dhe Rregulloren e Provimeve[216], neni 2. Studentëve ju bëhet me dije mënyra si do të vlerësohen (skema e vlerësimit me pikë dhe konvertuar në notë) në orën e parë të leksionit kur bëhet prezantimi i syllabus-it[217]. |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | *Po.* Në fillim të çdo lënde studentët njihen me syllabus-in e lëndës të prezantuar me detaje nga lektori përkatës[218]. Përgjatë prezantimit të syllabus-it studentëve ju bëhet me dije metodologjia e vlerësimit të njohurive për lëndën. Detyra e lektorit të lëndës për të prezantuar syllabusin në orën e parë të leksionit është e specifikuar në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit[219] në nenin 53. |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i | *Po.* Në Universitetin "Aleksandër Moisiu" testimi i njohurive dhe aftësive |

[211]Evidencë 174_Njoftime nga Institucioni për pjesëmarrje në Erasmus+
[212]Evidencë 37_Trajnime dhe mobilitete Erasmus +, PAE, v.a 2017-2022
[213]Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës
[214]Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut
[215]Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[216]Evidencë 59_Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit
[217]Evidencë 108_Syllabuse_sem 2_v.a. 2021-2022
[218]Evidencë 108_Syllabuse_sem 2_v.a. 2021-2022
[219]Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet

| | |
|---|---|
| njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | profesionale bëhet me anë të provimeve për secilën lëndë, pjesë e Rregullores së Provimeve, neni 2[220]. Vlerësimi i njohurive të studentëve për secilën lëndë bëhet nëpërmjet dy provimeve dhe mundësisë për detyrë kursi. Format e provimit janë në përputhje me specifikat e lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit sipas Rregullores së Departamentit të Financë Kontabilitetit[221] të parashikuar në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit[222], neni 59. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | ***Po.*** Mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe dijeve, janë të përcaktuara në syllabusin e lëndës[223]. Ky vlerësim është i ndarë në dy provime dhe në një detyrë kursi bazuar edhe në Rregulloren e Provimeve[224] në nenin 2, dhe në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit[225] në nenin 59. Studentët kanë mundësi për marrë notë kaluese dhe për ta përmirësuar atë nëpërmjet tre sezoneve (Sezoni i Dimrit, Sezoni i Verës dhe Sezoni i Vjeshtës) sipas nenit 63 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit[226] dhe nenit 6 të Rregullores së Provimeve[227]. Gjithashtu, mundësitë për tu diplomuar janë të përcaktuara dy herë në vit, në korrik dhe në shtator[228] [229]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | ***Po.*** Një ndër sistemet më efiçente për zhvillimin e provimeve ka qenë platforma Clean Score[230] [231] [232]. Gjithashtu, bazuar në Rregulloren e programit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"[233] sipas nenit 14, janë parashikuar dhe forma të tjera testimi bazuar edhe në llojin e lëndës nëse realizohet në laboratore apo në auditor. |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me | ***Po.*** Vlerësimi përfundimtar i lëndës [234] bëhet në përputhje me syllabusin[235] dhe bazën ligjore në fuqi[236] [237]. |

[220] Evidencë 59_Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit
[221] Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet
[222] Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[223] Evidencë 108_Syllabuse_sem 2_v.a. 2021-2022
[224] Evidencë 59_Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit
[225] Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[226] Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[227] Evidencë 59_Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit
[228] Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[229] Evidencë 193_Vendim për ngritje komisioni Ad-Hoc për mbrojtje praktike dhe mikroteze
[230] Evidencë 169_Email Njoftim Clean Score dixhitalizimit të procesit të zhvillimit të provimeve
[231] Evidencë 170_Trajnim për Clean Score 2018-2019
[232] Evidencë 171_Takim me përfaqësuesen e CleanScore Durrës dhe Departamentit Financë-Kontabilitet
[233] Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut
[234] Evidencë 204_Model Procesverbal Lëndë
[235] Evidencë 108_Syllabuse_sem 2_v.a. 2021-2022
[236] Evidencë 60_VKM nr. 41 datë 24.1.2018

| | |
|---|---|
| syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | ***Po.*** Referuar nenit 2 të Rregullores së Provimeve[238] dhe nenit 59 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit[239] studentit i krijohet mundësia që të zhvillojnë dy provime dhe një detyrë kursi. Në këtë mënyrë i jepet mundësi studentëve të përmirësohen përmes tre mundësive të vlerësimit. Gjithashtu, provimi i parë diskutohet në klasë duke i këshilluar për provimin e dytë. Nga ana tjetër detyra e kursit është një mundësi për t'i nxitur studentët të përmirësojnë vlerësimin e tyre përkundrejt vlerësimit që kanë marrë në provime. |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | ***Po.*** Mbështetur në nenin 3 dhe 4 të Rregullores së Provimeve[240] dhe në nenin 60 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit[241], proçesi i provimeve zhvillohet në prani të lektorit të lëndës dhe një lektori asistues[242]. Gjithashtu, në syllabus-in e lëndës është përcaktuar edhe Kodi i Etikës[243]. Programi antiplagjiaturë[244], i vendosur në Shtator të vitit 2022, ndihmon në kontrollin e detyrave të kursit dhe temave të diplomës. |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | ***Po.*** Një ndër parimet themelore të Institucionit është garantimi i të drejtave të studentit. Referuar nenit 60, pikës 7 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit[245], rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë, proces i cili bëhet transparent duke bërë ballafaqimin e rezultatit me studentin. |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | ***Po.*** Referuar nenit 5 të Rregullores së Provimeve[246] si dhe nenit 62 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit[247] është garantimi i të drejtës së studentëve për tu ballafaquar me rezultatin e provimeve dhe të drejtën e ankimimit të rezultatit në rastin kur e gjykon të pa drejtë vlerësimin. |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | ***Po.*** Çdo kërkesë apo ankimim i bërë nga studentët, shqyrtohet nga komisioni i cili është ngritur posaçërisht për këtë arsye me urdhër të përgjegjësit të departamentit Financë Kontabiitet. Proçedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet pranë sekretarisë mësimore sipas Rregullores së Fakultetit të Biznesit[248] referuar nenit 62. Megjithatë duke qënë se në Rregulloren e Provimeve dhe Rregulloren e Fakultetit të Biznesit, paraqitet detyrimi për lektorin për ballafaqim teze për provimin e ndërmjetëm dhe përfundimtar, kjo ka bërë që në programin e studimit MSc ISDR të mos ketë kërkesa për rishikim teze nga ana e studentëve. |

| **Shkalla e përmbushjes së** | **Nuk** | **Përmbushet** | **Përmbushet** | **Përmbushet** |
|---|---|---|---|---|

[237] Evidencë 79_VKM nr.879, datë 18.12.2019
[238] Evidencë 59_Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit
[239] Evidencë 59_Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit
[240] Evidencë 59_Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit
[241] Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[242] Evidencë 80_Asistime_Grafiku i provimeve perfundimtar_Master_sem 1_v.a.2022-2023
[243] Evidencë 108_Syllabuse_sem 2_v.a. 2021-2022
[244] Evidencë 173_Raporti i AKKSHI për laboratorin e doktoraturës datë 12.10.2022
[245] Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet
[246] Evidencë 59_Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit
[247] Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[248] Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit

| standardit | përmbushet | pjesërisht | kryesisht | plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi III.4**<br>**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. | ***Po.*** Programi i studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"[249] ka një kurrikul[250] të pasur që garanton pajisjen e studentëve me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, trajnim të mirëfilltë dhe profesional[251] dhe i përgatit ata të jenë të aftë të përballen me sfidat e tregut të punës[252]. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | ***Po.*** Programi i studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit nëpërmjet kurrikulës që ajo ofron dhe kategorive A/B/C/D të planit mësimor[253]. Referuar syllabuseve[254] të lëndëve që zhvillohen në këtë program studimi, vihet re metodologjia e ndjekur (me classroom, në laborator) për zhvillimin e aftësive të studentëve si dhe literatura referuese nga lektori gjendet në gjuhën shqipe por edhe në gjuhën angleze. |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. | ***Po.*** Në përfundim të çdo lënde lektorët realizojnë një orë përsëritje ku vënë në pah çështjet kryesore ku do të mbështeten studentët për provimin përfundimtar, referuar syllabusit të lëndës[255]. Në dispozicion të studentëve janë edhe oraret e konsultimeve që shpallen nga secili pedagog në fillim të çdo viti akademik[256]. Nga ana tjetër studentët kanë një javë pushim, e cila është cilësuar si javë për të bërë përsëritje të temave që do të përfshihen në provim[257]. Në fund të cdo semestri, lektorët nën kordinimin e Kordinatorit të programit të studimit dhe drejtuesit të njësisë bazë bëjnë orientimet e nevojshme për detyrimet përmbyllëse[258]. |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe | ***Po.*** Programi i studimit MSc ISDR i jep studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë (lëndë të caktuara) dhe praktikat profesionale[259] mbështetur edhe në Rregulloren e Praktikës Mësimore[260] në përfundim të ciklit të studimit. Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione dhe subjekte që ndihmojnë studentët të bëjnë praktika profesionale[261]. |

[249]Evidencë 71_Përshkrimi Program studimi Msc ISDR
[250]Evidencë 51_Riorganizimi i MSC ISDR v.a 2018-2019
[251]Evidenca 15_ Modeli i Suplementit të Diplomës.
[252]Evidencë 74_Pyetësor Vlerësimi i studentëve pas përfundimit të studimeve në BsC MsC MP
[253]Evidencë 49.1_Riorganizim Master nën 20%, 2022-2023
[254]Evidencë 108_Syllabuse_sem 2_v.a. 2021-2022
[255]Evidenca 19_Model syllabusi
[256]Evidencë 88_Orari i konsultimeve
[257]Evidencë 84_Kalendari Akademik Master 2021-2022 sem1
[258]https://www.facebook.com/photo?fbid=751454273039417&set=a.608866123964900
[259]Evidenca 91_Kurrikula dhe plani mësimor MSC ISDR me vula senati
[260]Evidencë 83_Rregullore për praktikat mësimore
[261]Evidencë 27_Marrëveshjet e bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit

| | |
|---|---|
| punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato nëpërmjet përfshirjes së studentëve në organizimin e Konferencës Studentore[262].<br>Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese brenda[263] dhe jashtë vendit duke ndihmuar që studentët të bëhen gjithashtu pjesë e projekteve të mobiliteteve, si Erasmus +[264]. |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | ***Po.*** Personeli akademik planifikon aktivitete në fillim dhe gjatë vitit akademik, si leksione të hapura ku ftohen personalitete të shquar të fushës, të cilët ndajnë përvojat e tyre profesionale me studentët dhe lektorët[265]. |
| **Kriteri 6.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | ***Po.*** Institucioni mbështet dhe i nxit studentët të bëhen pjesë e trajnimeve dhe ideve inovatore nëpërmjet thirrjeve të ndryshme të shpallura në faqen e Alumnit FB[266] dhe komunikimet me email[267] si dhe aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme[268] . |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë | ***Po.*** Procedura për detyrimet përmbyllëse është e mbështetur në Vendim nr. 41, datë 24.01.2018[269] dhe Vendim nr. 879, datë 18.12.2019[270], nenin 75 të Rregullores së UAMD-së[271], nenin 68 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit[272], nenit 17 të Rregullores së programit të studimit Master i |

[262]Evidenca 130_Historiku i konferencës studentore dhe njoftimet që I kemi cuar studentëve për pjesëmarrje
[263]Evidencë 137_Komunikim me emaile për praktika pune
[264]Evidenca 62_Njoftime nga institucioni per pjesemarrje në Erasmus +
[265]Evidenca 142_Leksionet e hapura dhe aktivitetet Dep. Financë Kontabilitetit (ndër vite)
[266]https://www.facebook.com/alumnifb.network
[267] Evidencë 94_Komunikim email_Njoftim mbi internship
Evidencë 44_Njoftim për Konkurse, projekte për studentët
[268] Evidencë 55_Aktivitete Fakulteti i Biznesit
[269] Evidencë 60_VKM nr.41 datë 24.1.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
[270] Evidencë 79_VKM nr.879, datë 18.12.2019 Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41 date 24.01.2018
[271]Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës
[272] Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit

| | |
|---|---|
| publike. | Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"[273], Rregullores së Praktikës[274] dhe Rregullores të Mikrotezës[275]. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse. | ***Po.*** Njësia kryesore në bashkëpunim me Njësinë Bazë asistojnë studentët nëpërmjet seancave të orientimit në auditorë me materiale specifike[276], njoftime në rrjetet sociale[277]. Sekretaria dhe Dekanati vënë në dispozicion Rregulloret e Diplomimit[278] përkatëse në Nenin 5, 6, Rregulloret e Praktikës[279] dhe Rregulloret e Diplomimit[280]. |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | ***Jo.*** Referuar Rregullores së Diplomimit[281], planit dhe kurrikulës mësimore, program i studimit Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut" në detyrimet përmbyllëse nuk përfshin provim final por ka të përcaktuar vetëm praktikë dhe mikroteze[282][283]. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | ***Po.*** Në nenin 2 të Rregullores së Diplomimit[284] janë përcaktuara detyrat kryesore të stafit akademik për orientimin dhe drejtimin e studentëve[285] [286]. Personeli akademik i caktuar si udhëheqës në temën e diplomës pasi ndihmon studentin në përgatitjen e temës finale, jep vlerësimin të paraqitur në formularët e vlerësimit të diplomës[287] sipas formatit që gjendet në Rregulloren e Diplomimit (aneksi D)[288]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | ***Po.*** Institucioni asiston studentët për kryerjen e detyrave të kursit dhe në punimin e temës së diplomës duke i vendosur në dispozicion laboratore dhe biblioteka (online dhe fizike)[289]. |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit | ***Po.*** Sipas nenit 11 të Rregullores së Diplomimit[290], studenti diplomohet duke |

[273] Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut
[274] Evidencë 83_Rregullore për praktikat mësimore
[275] Evidencë 82_Rregullore Diplomimi
[276] Evidencë 129_Dosje prezantimi te studenteve Master.pdf
[277]https://www.facebook.com/photo?fbid=751454273039417&set=a.608866123964900
[278]Evidencë 82_Rregullore Diplomimi
[279] Evidencë 83_Rregullore për praktikat mësimore
[280] Evidencë 82_Rregullore Diplomimi
[281] Evidencë 82_Rregullore Diplomimi
[282]Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut
[283]Evidencë 83_Rregullore për praktikat mësimore
[284]Evidencë 82_Rregullore Diplomimi
[285]Evidencë 181.1_Udhëheqësit Shkencore Master 2021-2022
[286] Evidencë 181_Komunikime me studentet e diplomes- Mcs ISDR.pdf
[287]Evidencë 196_Formular vlerësimi nga lektori udhëheqës
[288]Evidencë 82_Rregullore Diplomimi
[289]Evidencë 42_Informacion për Bibliotekën Online

| | |
|---|---|
| përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. | mbrojtur temën e diplomës dhe vlerësohet me notë[291]. Diploma dhe suplementi[292] i saj janë të miratuara nga Ministria Arsimit. |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | ***Po.*** Një ndër detyrat e institucionit është që në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës[293], të miratuara nga Ministria e Arsimit, e shprehur në nenin 23 dhe 24 të Rregullores së Sekretarisë për Fakultetin e Biznesit[294]. Në përfundim të studimeve, studenti njoftohet për tërheqjen e diplomës dhe suplementit[295]. |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | ***Po.*** Institucioni e ka të detyrueshme të ruajë dhe arkivojë sipas një afati të caktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, informacione për studentët nëse kërkohen[296] [297]. |

| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi III.6**<br>**Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | ***Po.*** Njësia kryesore dhe Njësia Bazë ofrojnë laboratorë me kompjutera[298], bibliotekë online[299] [300] dhe fizike, si dhe ambjente studimi dhe pune[301]. Gjithashtu, marrëveshjet e bashkëpunimi me institucione dhe biznese të ndryshme krijojnë mundësi për përfitimin e njohurive nëpërmjet praktikave profesionale[302]. |

---

[290] Evidencë 82_Rregullore Diplomimi
[291] Evidencë 126_Model Procesverbal Praktike dhe Mikroteze
[292] Evidencë 68_Suplement i Ri Msc ISDR
[293] Evidencë 68_Suplement i Ri Msc ISDR
[294] Evidencë 81_Rregullore e Sekretarisë Mësimore në FB
[295] Evidencë 68_Suplement i Ri Msc ISDR
[296] Evidencë 81_Rregullore e Sekretarisë Mesimore në FB
[297] Evidencë 82_Rregullore Diplomimi
[298] Evidencë 87_Lista me Laboratorët FB (Kendi i studentëve)
[299] Evidencë 41_Lista E-books e disponueshme
[300] Evidencë 42_Informacion për Bibliotekën Online
[301] Evidencë 87_Lista me Laboratorët FB (Kendi i studentëve)
[302] Evidencë 45_Analiza e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me Departamenti Financë Kontabilitet, v.a 2022-2023

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | ***Po.*** Institucioni me anë të bashkëpunimeve me partnerët ka bërë të mundur ndërtimin e laboratorit me kompjutera, i cili i vjen në ndihmë studentëve për përfitim sa më të mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale[303]. |
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | ***Po.*** Mënyra e zhvillimit të praktikës/hartimit të raportit të saj dhe vlerësimit është pjesë e Rregullores së Praktikës së FB[304] referuar nenit 4 dhe 5, ekuivalentohet në kredite[305] dhe dokumentohet me mbrojtje para komisionit dhe me dorëzim të procesverbalit me notë[306]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

[303]Evidencë 87_Lista e laboratorëve dhe Këndi i studentëve
[304]Evidencë 81_Rregullore e Sekretarisë Mesimore në FB
[305]Evidencë 49.1_Riorganizim Master nën 20%, 2022-2023
[306]Evidencë 126_Model Procesverbal Praktike dhe Mikroteze

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | *Po.* Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit Master Shkencor në Industrinë e sigurimit dhe drejtimit të rrezikut , i përmbush kërkesat ligjore, të përcaktuara në Ligjin për arsimin e lartë, Ligji Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij[307], kriteret e shpallura në departament për rekrutimet për lektorë me kohë të pjesshme.<br>Në departamentin Financë-Kontabilitet janë 16 lektorë efektiv, ku kualifikimi i tyre është i shpërndarë sipas të dhënave statistikore "Tituj dhe Grada", viti 2018-2023[308]. Arsimimi i lektorëve të departamentit Financë-Kontabilitet dhe rritja e tyre akademike në tituj dhe grada janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve që ata mbulojnë[309]. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit Msc. ISDR referuar fushës së studimit të tyre në Dosjet e Vetëvlerësimit[310] dhe në CV e rifreskuara[311] janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij dhe fushat e kërkimit shkencor të DEP. FK[312]. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | *Po.* Udhëzimi 29 i datës 10.09.2018 i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit përcakton ngarkesën mësimore të përsonelit akademik efektiv në IAL në bazë të kategorive të ndryshme. Personeli akademik efektiv i anagazhuar në programin e studimit Master Shkencor "ISDR" mbulon ngarkesën mësimore bazuar në kornizën ligjore në fuqi [313][314], referuar edhe ngarkesës mësimore deklaruar në Departament F-K[315]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në | *Po.* Marrëdhënia e punësimit në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës rregullohet nëpërmjet kontratës së punësimit si edhe personeli akademik i angazhuar mbulohet me sigurime shoqëore dhe shëndetësore.[316]Sipas kategorisës së ndarjes së lektorëve me tituj MSC/ Doktoraturë apo Kategoria |

[307] Evidencë 1_Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, 2015
[308] Evidencë 96_Departamenti Financë-Kontabilitet - Titujt dhe Gradat në vitet 2018-2023
Evidencë 96.1_Të dhëna për programin e studimit MSc ISDR
[309]Evidencë 189_Short Bio Dep Finanancë Kontabilitetit Qershor 2021
[310]Evidencë 19_Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Departamentit të Financë Kontabilitetit
[311]Evidenca 17_CV-të e lektorëve, Programi Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
Evidencë 17.1_CV-të PAK, Programi Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut, v.a 2021-2022
[312] Evidencë 26_ Fushat kërkimore shkencore për departamentin e Financë Kontabilitetit
[313] Evidencë 102_Udhëzim nr. 29 datë 10.09.2018, Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik
[314] Evidencë 69_Ngarkesa mësimore Departamenti Financë Kontabilitet, v.a 2019-2022
[315]Evidencë 69_Ngarkesa mësimore Departamenti Financë Kontabilitet, v.a 2019-2022
[316] Evidencë 116_Model Kontrate Pune - UAMD

| | |
|---|---|
| programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | Profesor. Programi i studimit ISDR mbulohet nga një staf me eksperiencë akademike mbi 10 vjet[317]. Çdo muaj Drejtoria e Shërbimeve Financiare e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës i përcjell me e-mail raportimin e pagës personelit akademik ku janë të detajuara dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. [318] |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | ***Po.*** UAMD rekruton personel akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ në përputhshmëri të plotë me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" (nenet 64-67), Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, Rregulloren e UAMD dhe Statutin e UAMD[319] .<br>Në varësi të strukturës së miratuar me anë të Vendimit të Këshillit të Administrimit nr. 30, datë 31.05.2018 "Për miratimin e strukturës së përgjithshme të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës" , Njësia Bazë përcakton kriteret që duhet të përmbushen nga aplikanti. Këto kritere i përcillen Drejtuesit të Njësisë Kryesore, i cili pasi i miraton ia përcjell Rektorit, referuar nenit 7 të Rregullores Drejtorisë Burimeve Njerezore dhe Juridike[320].<br>Mbi bazën kritereve të miratuara nga njësia bazë[321], shpallet konkurs i hapur "Për vendet të lira të punës për personel akademik me kohë të plotë" (ose të pjesshme) dhe kryhet publikimi në Buletinin e Njoftimeve Publike pranë Agjensisë së Prokurimeve Publike, në formë të shkruar dhe elektronike. Gjithashtu njoftimet publikohen edhe në faqen zyrtare të UAMD. [322] Për procedurën e rekrutimit ngrihet Komisioni Ad-Hoc[323]. Procesi i shpalljes së fituesve bëhet nëpërmjet procedurës së shqyrtimit të dosjes dhe intervistave duke ju referuar kritereve të shpallura në Dep. FK. |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | ***Po.*** Personeli ndihmës akademik i Fakultetit të Biznesit është i përbërë nga sekretaria e ciklit të dytë master, asistentja e departamentit dhe dy laborantë[324], të cilët ofron suport për veprimarinë mësimore të stafit akademikme kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Ky personel ka kualifikimin e duhur dhe i përshtatet nevojave dhe natyrës specifike të programit të studimit. |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan | ***Po.*** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e |

317 Evidencë 32_Analiza Vjetore e departamentit Financë Kontabilitet v.a 2021-2022 (Tabela e eksperiencës së punës)
318 Evidencë 124_Vertetim per kontributet e sigurimit shoqëror dhe shendetësor
319 Evidencë 13_Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës
Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
320 Evidencë 180_Rregullore Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Juridike
321 Evidencë 183_Kritere dhe vende vakante stafi i ri_nder vite
322 https://uamd.edu.al/mundesi-punesimi/)
Evidencë 186_Njoftim për staf akademik me kohë të pjesshme FB
323 Evidencë 119_Relacion mbi rekrutimin e lektoreve
Evidencë 183_Kritere dhe vende vakante stafi i ri_nder vite
Evidencë 194_Kriteret per Rekrutimi i stafit Full Time
324 Evidencë 96.1_Të dhëna për programin e studimit MSc ISDR (Tabela 2)

| | |
|---|---|
| dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | personelit të angazhuar në programin e studimit. Dega e Burimeve Njerëzore në bazë të nenit 24 në Statutin[325] e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës është përgjegjëse për përditësimin e dosjeve të stafit akademik me kohë të plotë, personelit ndihmës akademik dhe administrativ duke e vënë informacionin në dispozicion të njësive bazë. Çdo vit akademik personeli akademik plotëson formularët e vetëvlerësimit ku pasqyrohet progresi shkencor dhe akademik mbi të cilin bëhet vlerësimi i performancës nga Drejtuesi i NjësisëBazë dhe Njësia Kryesore.Të dhënat për angazhimin e stafit aakdemik në programin e studimit gjenden edhe nëanalizën vjetore të DEP. FK (ngarkesa mësimor).[326] Gjithashtu "Baza e të dhënave të Kërkimit Shkencor" mundëson monitorimin në kohë reale të aktiviteti të kërkimit shkencor duke mundësuar një vlerësim periodik dhe një rankim në kohë reale të tij. Ky rankim bëhet në nivel kombëtar (sipas fushave) përmes portalit "Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore shkencore", në platformën ACRIS (Sistemi shqiptar i informacionit të kërkimit shkencor) që administrohet nga AKKSHI. |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | ***Po.*** Universiteti "Alesandër Moisiu" Durrës, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Financë-kontabilitetit kanë marrëveshje me IAL dhe organizata biznesi. Studentët kanë në dispozicion Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike që ka nën varësi Sektorin e Karrierës dhe të Alumnit, ku Neni 15 i rregullores së kësaj Drejtorie përcakton funksionimin e Sektorit të Karrierës dhe Alumni dhe shërbimeve që ajo ofron për studentët në procesin e praktikës dhe punësimit.[327] Në rregulloren e Praktikës Mësimore përcaktohen strukturat përgjegjëse të praktikës mësimore në Nenin 3 të saj dhe në Nenin 4 procesi i zhvillimit të praktikës mësimore.[328] Në rregulloren e tezës së diplomës në Nenin 2 dhe Nenin 3 përcaktohet udhëheqësi dhe përgjegjësit e udhëheqësit të diplomës. [329]<br>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimimi[330] me IAL të tjera, përfaqësues biznesi dhe kompani, të cilat lehtësojnë zhvillimin e praktikave mësimore dhe realizimin e punimeve të diplomës. |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | ***Po.*** Procesi i praktikës mësimore për studentët master është bazuar në nenin 4 të Rregullores së Praktikës Mësimore[331] dhe në bashkëpunim me institucionet me të cilat UAMD dhe FB ka marrëveshje bashkëpunimi.[332]<br>Referuar rregullores, lektorët bëjnë dhe vlerësimin e studentit[333] dhe vlerësimi përfundimtar bëhet para komisionit të praktikave.[334] |

| **Shkalla e përmbushjes së** | **Nuk** | **Përmbushet** | **Përmbushet** | **Përmbushet** |
|---|---|---|---|---|

[325]Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
[326] Evidencë 32_Analiza Vjetore e departamentit Financë Kontabilitet v.a 2021-2022
[327]Evidencë 111_ Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike
[328] Evidencë 83_Rregullore për praktikat mësimore
[329] Evidencë 82_Rregullore Diplomimi
[330] Evidencë 45_Analiza e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me Departamenti Financë Kontabilitet, v.a 2022-2023
[331] Evidencë 83_Rregullore për praktikat mësimore
[332] Evidencë 27_Marrëveshjet e bashkëpunimit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës dhe Fakultetit të Biznesit
[333]Evidencë 196_Formular vlerësimi nga lektori udhëheqës
[334] Evidencë 193_Vendim për ngritje komisioni Ad Hoc për mbrotje praktike dhe mikroteze

| standardit | përmbushet | pjesërisht | kryesisht | plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | ***Po.*** Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Procesi mësimor zhvillohet në tre godina, një në Currila dhe dy në KampusinUniversitar, Spitallë duke krijuar kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për zhvillimin e veprimtarisë mësimore.<br>Fakulteti i Biznesit e zhvillon procesin mësimor dhe veprimtarinë akademike në Godinën Nr.2 të Kampusit Universitar, Spitallë. Në këtë godinë disponohen mjedise të mjaftueshme mësimore: 15 auditorë, 2 laboratorë, bibliotekën dhe sallën e konferencave të cilat janë të dispozicion të procesit të mësimdhënies dhe studimit për të garantuar veprimtarinë mësimore të programit të studimit.[335] |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | ***Po.*** Mjediset mësimore dhe laboratorike në Fakultetin e Biznesit, që ndodhen në godinën Nr.2 të Kampusit Universitar në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, janë të pajisuara me të gjitha pajisjet e nevojshme teknologjike dhe digjitale që janë të nevojshme për procesin e mësimdhënies dhe mësim nxënies. Të gjitha klasat janë të pajisura me tabela whiteboard dhe mundësi për videoprojektor të lëvizshëm (dhe të montuar), të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimit në kushte bashkëkohore.<br>Zyrat e personelit akademik dhe administrativ që gjenden në këtë godinë, janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (kompjuter, printer, tavolinë pune, dollap etj) Laboratorët janë të përshtatshëm për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit dhe përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve. [336] |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, ateliетё apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | ***Po.*** Laboratorët e Fakultetit të Biznesit plotësojnë nevojat e studentëve të programit Master Shkencor ISDR duke i ofruar pajisjet e duhura teknologjike dhe digjitale në mënyrë që të plotësohen nevojat e tyra për studim dhe kërkim shkencor. Dy laboratorë janë në funksion të Fakultetit të Biznesit për studentët master, të cilët përfshijnë gjithsej 80 vende me një sipërfaqe 134.4 $m^2$. Laboratorët janë të pajisur me programe standarte por edhe specifike si Financa 5, eviews të cilat plotësojnë nevojat e studentëve për studim dhe kërkim shkencor.[337] Gjithashtu FB I është shtuar dhe laboratori i Doktoraturës i cili është i pajisur me software e fundit si eviews/ spss/ program antiplagjiaturë/ Grammarly etj[338]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të | ***Po.*** Institucioni me kapacitetet që zotëron garanton, infrastrukturën e |

[335]Evidencë 92_Infrastruktura, Planimetria e FB
[336] Evidencë 122_Informacion mbi pajisjet hardware dhe software në Fakultetin e Biznesit
[337] Evidencë 173_Raporti i AKKSHI për laboratorin e doktoraturës datë 12.10.2022
[338]Evidencë 173_Raporti i AKKSHI për laboratorin e doktoraturës datë 12.10.2022

| | |
|---|---|
| lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | mjaftueshme për zhvillimin e praktikave laboratorike. FB ka dy laboratorë që janë në funksion të studentëtve të bachelor BF me gjithsej 80 vende me një sipërfaqe 134.4 $m^2$. Laboratorët janë të pajisur me programe standarte por edhe specifike si Financa 5për plotësimin e nevojave të studentëve për studim dhe kërkim shkencor.[339][340] |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme. | **NA** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi IV.3**<br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | ***Po.*** Në çdo fillim semestri studentët e programit të studimit Msc ISDR, njihen me literature bazë dhe ndihmëse të kërkuar për realizimin me sukses të procesit mësimor, sikurse është parashikuar në syllabuset e lëndëve.<br>Kjo literaturë është vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit nga personeli akademik duke garantuar marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. Literatura bazë për çdo lëndë që ofrohet në këtë program studimi është në gjuhën shqipe dhe angleze.[341]<br>Biblioteka Shkencore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës siguron literature bazë dhe ndihmëse nëpërmjet ofrimit të sallës me fond të hapur me literaturë referenciale, periodike, literaturë prej burimeve elektronike të bibliotekës, literaturë me burime elektronike të huaja. Literatura e vënë në dispozicionin e studentëve mbështet nevojat e tyre mësimore dhe të kërkimit shkencor. Biblioteka disponon gjithashtu edhe një fond të mbyllur. 80% e |

[339]Evidencë 122_Informacion mbi pajisjet hardware dhe software në Fakultetin e Biznesit
[340]Evidencë 92_Infrastruktura, Planimetria e FB
[341] Evidencë 108_Syllabuse_sem 2_v.a. 2021-2022

| | |
|---|---|
| | literatures së vënë në dispozicion është e 5-7 viteve të fundit dhe nga shtëpitë botuese të mirënjohura ndërkombëtarisht. Mbështetur në nenin 38 të Rregullores së Shërbimeve Akademike[342] studentët nëpërmjet Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) kanë akses në platformënU-Albania. Literatura bazë është e mbledhur edhe në listën e titujve në Bibliotekë për programin e studimit.[343] |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | ***Po.*** Biblioteka e UAMD kryen periodikisht blerje për Institucionin nëpërmjet donatorëve të huaj, të cilët sigurojnë botime në mënyrë fizike dhe elektronike[344345]. Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, bën vazhdimisht përpjekje për realizimin e kërkesave për blerje librash për njësitë bazë[346], në varësi të nevojave për pasurimin e fondeve por dhe përditësimin e literaturës e cila pasqyrohet në syllabuset e lëndëve duke kontribuar në cilësinë e mësimdhënies[347]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | ***Po.*** UAMD vë në dispozion të studentëve dhe personelit akademik bibliotekën mësimore e cila mundëson jo vetëm ambjente studimi por edhe ambjente sociale si edhe ambiente të cilat mund të shfrytëzohen nga studentë dhe kërkues për promovimin e veprimtarisë dhe aktiviteteve të ndryshme hulumtuese si edhe garanton ofrimin e shërbimeve për një akses të hapur. Sipas nenit 32 të Rregullores së Drejtorisë së Administrimit të Shërbimeve Akademike përdorues i bibliotekës është personi juridik ose fizik që paraqet një kërkesë me shkrim ose jo për të përfituar falas ose sipas tarifave të miraturara një shërbim që ofrohet nga Biblioteka e UAMD. [348] Studentëve i është në dispozicion dhe dy bibliotekat online jstore dhe ebsco[349]. |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | ***Po.*** Në nenin 39 të Rregullores së Drejtorisë së Administrimit të Shërbimeve Akademike, specifikohet që Biblioteka Universitare e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës" ka abonim në 30 revista shkencore, kryesisht në anglisht, italisht dhe gjermanisht, 600 tituj libra akademik në gjuhë të ndryshme, akses në periodikun shqip të periudhës 1945-2007, literaturë në gjuhë të huaj, revista[350], gazeta, fjalorë dhe enciklopedi, arshivën akademike, arshivën digjitale. Insitutcioni vë në dispozicion gjithashtu edhe Listën e Paketave që përfshihen në U-LIBRARY dhe j-stor.org [351352] |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | *Po.* Njësia bazë harton raporte analitike[456], periodike[457], mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Për hartimin e këtyre raporteve merret në konsideratë mendimi i studentëve të rinj që rregjistrohen për herë të parë dhe mendimi i tyre pas diplomimit[458]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë | *Po.* Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit[459] duke b[r[ lajm[rimet e nevojshme. |

[451] Evidencë 138_Komunikim me Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike
[452] Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
[453] Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës
[454] Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet
[455] Evidencë 30_ Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[456] Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc ISDR
[457] Evidencë 128_Analiza e rregjistrimeve për programin Master Shkencor ISDR
[458] Evidencë 72_Pyetësor - Përzgjedhja e studimeve Bsc Master pranë UAMD
Evidencë 74_Pyetësor Vlerësimi i studentëve pas përfundimit të studimeve në BSC MSC MP
[459] Evidencë 146_Shkresë_Për zgjedhjen e studentëve për anëtar Bordi

| | |
|---|---|
| institucionit. | |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | ***Po.*** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim nëpërmjet bashkëpunimit me zyrën e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë ku shpërndahet një pyetësor[460] dhe merret mendimi i drejtëpërdrejtë i studentëve mbi përmirësimin e procesit akademik. |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | ***Po.*** Njësia Bazë kërkon mendimin e studentëve të diplomuar rreth procesit mësimor, kualifikimit të stafit, përmirësimeve të mundshme[461]. Përgjigjet e këtij vlerësimi bëhen pjesë e diskutimeve në department[462] dhe në Analizën e Ecurisë së Programit të Studimit MSC ISDR[463]. |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | ***Po.*** Referuar nenit 62 të Rregullores së FB[464], studentët kanë mundësinë e dhënies së mendimit mbi proçesin e vlerësimit të tyre. Lektorët, bazuar në rregullore kanë detyrimin e ballafaqimit të rezultatit me studentët duke qenë transparent mbi vlerësimin e bërë. Kjo praktikë ka sjellë që në programin e MSC ISDR të mos ketë asnjë ankimim. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet | ***Po.*** Referuar nenit 8 të Rregullores së FB[465], Rregullores së sekretarisë, Rregullores së Dep. FK, janë përcaktuar zyrat në shërbim të informimit të studentëve si Sekretaria, Zyra e financës, Zyra e marrëdhënieve me jashtë, zyra e studentëve dhe Alumnit (Network FB), zyra e Karrierës UAMD. Gjithashtu Zv. Dekania e Anës Mësimore dhe Departamentet janë gjthmonë në |

[460]Evidencë 131_Pyetësor mbi rezultatet e anketimit të studentëve, të stafit akademik dhe administrativ mbi Institucionin, v.a 2017-2018
[461]Evidencë 74_Pyetësor Vlerësimi i studentëve pas përfundimit të studimeve në BSC MSC MP
[462]Evidencë 75_Mbledhje Departamenti PCV
[463]Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc ISDR
[464]Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[465]Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit

| | |
|---|---|
| rregullatore të institucionit. | dispozicion të studentëve për cdo problematikë dhe kërkesë për informacion. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | ***Po.*** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, duke përcaktuar zyrat në shërbim të informimit të studentëve si Sekretaria, Zyra e Financës, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e studentëve dhe Alumnit (Network - FB), Zyra e Karrierës - UAMD. Zv. Dekania e Anës Mësimore dhe Departamentet, si edhe Kordinatori i MSC ISDR janë gjthmonë në dispozicion të studentëve për cdo problematikë dhe kërkesë për informacion. Gjithashtu, studentët asistohen nëpërmjet përdorimit të Pitagorës, rrjeteve sociale[466], faqes zyrtare të UAMD[467]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | ***Po.*** Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nga Sektori i Karrierës dhe Alumnit[468] dhe Alumni Network FB[469]. Institucioni bën informim të vazhdueshëm të studentëve, organizon aktivitete të ndryshme me partnerët e FB për bashkëpunim me biznesin për orientimin e praktikës profesionale[470].<br>Gjithashtu dhe njësia bazë ndihmon në orientimin e studentëve drejt këtyre zyrave duke shfrytëzuar marrëveshjet e bashkëpunimit me FB (komunikim me studentët për pozicione pune në institucione financiare)[471]. |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | **Po.** Zyra/njësia e karrierës pranë UAMD[472] në bashkëpunim me Alumni Network FB[473] mbajnë dhe përpunojnë të dhëna për studentët e diplomuar (lista bashkëngjitur te Alumni Network FB)[474]. Alumni Network FB shpërndan një pyetësor për gjurmimin e studentëve pas diplomimit të tyre[475]. Komunikimet për aplikime për punë dhe internshipe të ndryshme realizohen nëpërmjet rrjeteve sociale[476] dhe komunikimit me email[477]. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së** | **Nuk** | **Përmbushet** | **Përmbushet** | **Përmbushet** |

[466]https://www.facebook.com/alumnifb.Network
https:// www.instagram.com/fb_uamd/
https:// www.facebook.com/NeJemiUAMD
https:// www.facebook.com/profile.php?id=100045245540366
[467]https://uamd.edu.al
[468]https://uamd.edu.al/karriera/
[469]Evidencë 39_Alumni Network FB Raport
https:// www.instagram.com/alumnifb.Network/
[470]Evidencë 137_Komunikim me emaile për praktika pune
[471]Evidencë 134_Komunikim me emaile per praktika pune_Banka Intesa San Paolo
[472]https://uamd.edu.al/karriera/
[473]https://www.instagram.com/alumnifb.Network/
[474]Evidencë 39_Alumni Network FB Raport
[475]Evidencë 127_Alumni Network_Pyetësor
[476] https:// www.instagram.com/alumnifb.Network/
https://www.facebook.com/alumnifb.Network
[477] Evidencë 198_Njoftim punësimi për studentët

| standardit | përmbushet | pjesërisht | kryesisht | plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi VI.1<br>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | *Po.* Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës ka si objektiv zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve, si dhe promovimin e kulturës së rritjes së vazhdueshme duke ju referuar Rregullores së NJBSC[478] të shprehur në nenin 1 dhe 5. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | *Po.* Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës-akademik, mbështetur në nenin 1 dhe 5 të Rregullores së Sigurimit të Cilësisë[479]. Disa nga mekanizmat që përdoren për monitorimin e këtyre aftësive janë: formularët e vetëvlerësimit[480] dhe CV e përditësuara të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme[481]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | *Po.* Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.<br>Studentët luajnë një rol shumë të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, dhe kjo gjë realizohet me anë të pyetësorëve[482] që plotësojnë çdo fund semestri si dhe me të drejtën e tyre për ankimime të provimeve të shprehur në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit/ neni 62[483]. Gjithashtu format e përmirësimit të mësidhënies janë të specifikuara në nenin 6 të Rregullores së Sigurimit të Cilësisë[484]. |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | *Po.* Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, në UAMD, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit të pyetësorit të kryer për çdo semestër akademik[485].<br>Rezultatet e përftuara i vihen në dispozicion strukturave vendimmarrëse të fakultetit, si dhe në mënyrë individuale të gjithë anëtarëve të Stafit Akademik, të vlerësuar. |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe | *Po.* UAMD, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik[486] për |

[478]Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[479]Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[480]Evidencë 19_Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Departamentit të Financë Kontabilitetit
[481]Evidenca 17_CV-të e lektorëve, Programi Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
Evidencë 17.1_CV-të PAK, Programi Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut, v.a 2021-2022
[482]Evidencë 131_Pyetësor mbi rezultatet e anketimit të studentëve, të stafit akademik dhe administrativ mbi Institucionin, v.a 2017-2018
[483]Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[484]Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[485]Evidencë 161_Monitorim i proçesit mësimor
[486]Evidencë 135_Trajnim Stafi_Projekt

| | |
|---|---|
| rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies si në rastin e mësimdhënies online[487], mësimdhënies nëpërmjet mobiliteteve[488], përdorimit të metodave të reja si cleanscore[489]. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | ***Po.*** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale sipas Ligjit të Ri,[490] Rregullores së UAMD, neni 30[491]. Në Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës rolin e NjSBC e luan Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë[492] referuar nenit 8.<br>Institucioni i jep rëndësi të veçantë Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, duke garantuar që veprimtaria e tij është në përputhje me të gjitha dispozitat e legjislacionit në fuqi, Statutit dhe akteve të tjera të brendshme rregullatore, por njëkohësisht me objektivat strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës[493]të cilat drejtojnë punën e periodike të strukturave drejtuese dhe personelit. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | ***Po.*** Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.<br>Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në nivel institucional si dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC) ushtrojnë kompetencat me funksione të plota në ruajtjen e standardeve dhe sigurimin e cilësisë[494] të Institucionit. Prioritetet strategjike të Universitetit[495], edhe të Fakultetit[496], janë të fokusuara në përmirësimin e vazhdueshëm në drejtim të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, ku studentët janë në qendër të filozofisë së universitetit, mbështetur nga grupet e interesit. |

[487]Evidencë 168_Njoftim Trajnim për mësimin online
[488]Evidencë 37_Trajnime dhe mobilitete Erasmus +, PAE, v.a 2017-2022
[489]Evidencë 170_Trajnim për Clean Score 2018-2019
[490]Evidencë 1_Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, 2015
[491]Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës
[492]Evidencë 30_ Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[493]Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës
[494]Evidencë 30_ Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[495]Evidencë 4_ Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025
[496]Evidencë 11_Plani Strategjik, Fakulteti i Biznesit, 2021-2025

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Instítucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | *Po.* Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL[497]. Llojet e akreditimit, afatet dhe procedurat shprehen qartësisht në pjesën gjashtë të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë[498]. Sipas Ligjit Nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në vitin akademik 2016 (duke u vlerësuar me një akreditim për 4 vite akademike) dhe është ri akredituar në vitin 2021 në nivel institucional[499]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit. | *Po.* NjSBC ndërmjet Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë në fund të çdo semestri javën e 13 dhe javën e 14, organizon anketimin me studentët për të vlerësuar stafin akademik. Njësia e Sigurimit të Cilësisë vlerëson periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore.<br>Në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimeve që ofron UAMD dhe strukturat e saj si NjBSC; Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë dhe Koordinatorët e programeve përgatisin raporte periodike (3-mujorë, 6-mujorë dhe vjetorë) të vetëvlerësimit të cilët i propozohen Senatit Akademik për miratim. Gjithashtu DKSC realizon Raportin e vetëvlerësimit për çdo vit akademik referuar Rregullores së Sigurimit të Cilësisë, Pjesa 6, neni 9[500]. NjBSC monitoron dhe vlerëson procedurat dhe standardet e fakulteteve dhe njësive të tjera të institucionit, sipas sistemit dhe mekanizmit të krijuar, duke analizuar dhe krahasuar rezultatet në bazë të treguesve të cilësisë, në bazë të kritereve dhe standardeve të paracaktuara në Kodin e Cilësisë[501] dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe | *Po.* Në Fakultetin e Biznesit, përdoren metoda të ndryshme si, kontrollet nga drejtuesit e Njësive Kryesore[502503], dhe Dekantit së Njësive Bazë, analizat dhe diskutimet në mbledhje të departamentit dhe fakultetit, anketimet e studentëve dhe aktorëve të tjerë[504], matjet e performancës së pedagogëve[505] me anën e disa |

[497]Evidencë 99_Manual afatet e akreditimit IAL dhe programet, 2017
[498] Evidencë 30_ Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[499]Evidencë 192_Vendim Nr.18, datë 24.03.2022 i Bordit të Akreditimit
[500]Evidencë 30_ Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[501]Evidencë 30_ Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[502] Evidencë 128_Analiza e rregjistrimeve për programin Master Shkencor ISDR
[503] Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc ISDR

| | |
|---|---|
| mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.<br>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | kritereve të standartizuara më parë, referuar Rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë[506]. Procesi i brendshëm i cilësisë përbëhet nga një procedurë ku zhvillohen aktivitete të rregullta monitoruese dhe përmirësuese[507]. Përveç monitorimit të rregullt (çdo vit dhe pjesërisht edhe çdo semestër) dhe përmirësimit, baza kryesore e këtyre aktiviteteve janë raportet e vetëvlerësimet që mund të zhvillohen së paku çdo gjashtë vjet në funksion të proceseve të akreditimit nga ASCAL ku b[het certifikimi i nevojshëm për të qenë IAL e akredituar[508509]. Në rastin e akreditimit të programeve të studimit raportet e vetëvlerësimit hartohen nga GVB-ja në nivel programi[510], ndërsa në rastin e akreditimit institucional nga GVB e ngritur në nivel institucioni. Lektorët në mënyrë të herëpashershme dorëzojnë te koordinatorët e kërkimit shkencor formularët e raporteve të veprimtarisë së tyre kërkimore shkencore[511]. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e proçese të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve sipas rregullores së NJSBC[512]. Programet e studimit në Fakultetin e Biznesit i janë nënshtruar riorganizimit në vitin akademik 2018-2019[513], kjo për arsye që të pajisë studentët me njohuri e shprehi të avancuara dhe me kompetenca të gjëra që kërkohen për t'u punësuar në përputhje me nevojat e tregut të diversifikuar të punës, ku synohet që të ofrohet një program studimi bazuar në kurrikula më bashkohore.<br>Nga DKSC realizohet kontrolli i kurrikulave të propozuara, sipas akteve ligjore në fuqi mbi riorganizimin mbi 20%, nën 20% si dhe për hapjet e programeve të reja[514]. |
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | ***Po.*** Raportet analitike dhe vlerësuese përmbajnë të dhëna për ecurinë e deritanishme, realizimin e pritshmërive në raport me objektivat, parashikimet për periudhat e ardhshme, si edhe adresimin e mangësive për përmirësime të mëtejshme të cilësisë. DKSC ndihmon në hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të institucionit i cili paraqet një studim të funksionimit institucional të UAMD-së dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë për vitin akademik dhe Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të Fakultetit të Biznesit[515]. |

[504] Evidencë 72_Pyetësor - Përzgjedhja e studimeve Bsc Master pranë UAMD
Evidencë 73_Pyetësor shpërndarë ekspertëve për përmirësimin e kurrikulave
Evidencë 74_Pyetësor Vlerësimi i studentëve pas përfundimit të studimeve në BsC MsC MP
[505] Evidencë 19_Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Departamentit të Financë Kontabilitetit
[506] Evidencë 30_ Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[507] Evidencë 161_Monitorim i proçesit mësimor
[508] Evidencë 192_Vendim Nr.18, datë 24.03.2022 i Bordit të Akreditimit
[509] Evidencë 203_Akreditimi i UAMD
[510] Evidencë 70_Ngritja e grupeve të GVB për proces Akreditimi
[511] Evidencë 153_Kërkesë për informacion për kërkimin shkencor
[512] Evidencë 162_Njoftim për plotësimin e dosjes së vetëvlerësimit Njësia Bazë_Njësia Kryesore
[513] Evidencë 51_Riorganizimi i MSC ISDR v.a 2018-2019
[514] Evidencë 30_ Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[515] Evidencë 106_Raporti i vlerësimit të brendshëm FB 2018-2019

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | *Po.* Në kuadër të përmirësimit të cilësisë përdoren metoda të drejtpërdrejta, duke iu referuar Rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë[516] dhe Raportimit për sistemin e brendshëm për sigurimin e cilësisë për Institucionin dhe Raportin e Vlerësimit të brendshëm për FB[517]. Në këto raporte përdoren metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. DKSC përmes sistemit të saj të informacionit mban të dhëna të ndryshme mbi institucionin dhe mbledh të dhëna nga NjBSC-të në nivel Fakulteti dhe Koordinatorët e Programeve[518]. DKSC-ja bashkëpunon me strukturën përgjegjëse të institucionit për të dhënat statistikore, që do të parashikojnë një analizë sistemike të këtyre treguesve referuar Rregulllores së Sigurimit të Cilësisës[519]. Strukturat e ndryshme të SBSC-së kryejnë mbledhjen e të dhënave, në varësi të llojit të informacionit të kërkuar dhe analiza përcillet në NjBSC. Gjithashtu lektorët dorëzojnë në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme CV-të[520] dhe dosjet e tyre te vetëvleresimit[521] të cilat i disponojnë të gjithë përgjegjësit e departamenteve dhe tek burimet njërëzore. Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve vlerësohen nga drejtuesi i njësisë bazë dhe nga drejtuesi i njësisë kryesore[522] referuar Shkresës së Rektorit Nr. 900 prot., me datë 1.6.2022[523]. Në bazë të formularëve të raporteve çdo lektor vlerësohet me pikë për çdo fushë të kërkimit të tij shkencor gjatë një viti akademik, vlerësimi bëhet në bazë të formatit të vlerësimit[524] i cili përmblidhet nga koordinatori i kërkimit shkencor[525] i cili është përzgjedhur me vendim departamenti. |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që | *Po.* Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve[526], të diplomuar (Alumni)[527], të personelit akademik[528], ndihmësakademik e administrativ[529], punëdhënësve dhe institucioneve që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.<br>Rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë ka përfshirja e studentëve në këtë proçes dhe i grupeve të tjera të interesit. Instrumentat e përdorura për metodën tërthortë (sondazhe, intervista) janë pasqyruar në nenet 6 dhe 15 të Rregullores |

516 Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
517 Evidencë 106_Raporti i vlerësimit të brendshëm FB 2018-2019
518 Evidencë 155_Emaile Komunikimi te DKSC me kordinatoret e programeve te studimit
519 Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
520 Evidenca 17_CV-të e lektorëve, Programi Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
521 Evidencë 19_Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Departamentit të Financë Kontabilitetit
522 Evidencë 162_Njoftim për plotësimin e dosjes së vetëvlerësimit Njësia Bazë_Njësia Kryesore
523 Evidencë 165_Shkresa e Rektorit_Nr. 900 Prot, date 1.6.2022
524 Evidencë 160_Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore te personelit akademik 2017–2018
525 Evidencë 56_Vendimi i përcaktimit të kordinatorit të kërkimit shkencor
526 Evidencë 131_Pyetësor mbi rezultatet e anketimit të studentëve, të stafit akademik dhe administrativ mbi Institucionin, v.a 2017–2018
527 Evidencë 147_Alumni UAMD
528 Evidencë 131_Pyetësor mbi rezultatet e anketimit të studentëve, të stafit akademik dhe administrativ mbi Institucionin, v.a 2017–2018
529 Evidencë 131_Pyetësor mbi rezultatet e anketimit të studentëve, të stafit akademik dhe administrativ mbi Institucionin, v.a 2017–2018

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë[530]. NjSBC në çdo rast dokumenton dhe u bën të njohur Senatit Akademik informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit. Një prej instrumenteve për analizën e arritjeve të misionit institucional është përcaktimi i një grupi treguesish kyç të performancës (TKP)[531] sipas nenit 17 të Rregullores së NjSBC[532]. Në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimeve që ofron UAMD-ja dhe strukturat e saj si NjSBC. Lista e TKP-së realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NjSBC-ja dhe i propozohet për miratim Senatit Akademik nga KPSC-ja. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | *Po.* UAMD ka parashikuar dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programeve të studimit. UAMD i jep prioritet angazhimit të studentëve në cdo nivel të vendimarrjeve[533]. Përfaqësues të studentëve gjenden në çdo organ kolegjial duke filluar nga Senati Akademik[534] e deri tek GVB[535] që ka hartuar këtë Raport të Vlerësimit të Brendshëm. Përfaqësimi i studentëve realizohet edhe në Bordin e Administrimit[536] [537], përfaqësi e studentëve marrin pjesë edhe në mbledhjet e Dekanatit dhe Departamentit[538] kur trajtohen çështje të lidhura me ta. |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | *Po.* Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Përgjegjësitë dhe detyrat konkrete janë të përcaktuara në Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë[539] dhe në Rregulloren e Fakultetin e Biznesit (UAMD)[540] përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Përfshirja e personelit |

530 Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
531 Evidencë 166_TKP_Pyetësor mbi mësimdhënien Online
532 Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
533 Evidencë 157_Komunikim_Pjesëmarrje e studenteve ne vendimet e Senatit Akademik
534 Evidencë 167_Urdher 522 date 1.12.2022 per nje ndryshim ne urdhrin nr. 499 datë 21.11.2022_Zgjedhje anëtari student për Senatin Akademik
535 Evidencë 70_Ngritja e grupeve të GVB për proces Akreditimi
536 Evidencë 154_Email për njoftimin e zgjedhjeve Student për anëtar Bordi Administrimi
537 Evidencë 154_Email për njoftimin e zgjedhjeve Student për anëtar Bordi Administrimi
538 Evidencë 178_Vendime ne mbledhje departamenti 06.10.2022
539 Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
540 Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit

| | |
|---|---|
| | akademik dhe studentëve në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në takime dhe komisione si, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, nëpërmjet ngritjes së grupit të punës së vlerësimit të brendshëm[541]. |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit. | *Po.* Në vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përfshihen studentët, lektorët, strukturat në nivel fakulteti, departamenti dhe në rang universiteti. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohet përfshirja e Fakultetit të Biznesit (Dekanati), e departamentit përgjegjëse FK për programin e studimit MSC ISDR, në mbledhjet[542] e mbajtura në departament si cilësia e syllabus-eve, e literaturës së rë, e Analizës së Rregjistrimit të Studentëve[543], e Analizës së Ecurisë së programit të studimit[544] dhe cdo problematike specifike gjatë një viti akademik. Cilësia e mësimdhënies realizohet në nivel titullar i lëndës, lektorë më kohë të pjesshme të cilët mbikëqyren dhe monitorohen nga titullari i lëndës[545]. Lektorët raportojnë për mësimin online (v.a 2021-2022) tek drejtuesi i njësisë bazë mbi procesin e mësimdhënies[546]. Drejtuesi i Njësisë Bazë kontrollon procesin mësimor dhe materialet e përdorura nga lektorët me kohë të pjesshme[547] dhe rakordon në raport me lektorët titullarë dhe lektorët me kohë të pjesshme. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit, drejtuesi i Njësisë Bazë bashkëpunon për raportimin e monitorimit të zhvillimit të mësimit Dekantit dhe NJSBC, si në situatën e procesit mësimor online gjatë pandemisë[548]. |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | *Po.* Respektimi i standardeve akademike dhe integriteti akademik i personelit të përfshirë në sigurimin e cilësisë në fakultet janë parime themelore për këtë institucion. Përzgjedhja e personelit për këtë proçes bazohet në kontributin, seriozitetin dhe integritetin akademik. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve, bazuar në Rregulloren e UAMD[549], Fakultet të Biznesit[550] dhe Rregulloren e NJSBC[551]. |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që | *Po.* Konform Ligjit për Arsimin e Lartë[552], referuar Manualit ASCAL[553] përfshihen si pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm[554] që kanë lidhje me programin e studimit që japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e tij. |

541 Evidencë 70_Ngritja e grupeve të GVB për proces Akreditimi
542 Evidencë 178_Vendime në mbledhje departamenti 06.10.2022
543 Evidencë 128_Analiza e rregjistrimeve për programin Master Shkencor ISDR
544 Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc ISDR
545 Evidencë 85_Korrenspondeca Komunikimi lektori titullar dhe lektori PT
546 Evidencë 91_Raportim lektore_Mbi sigurimin e përmbushjes së standardeve të cilësisë
547 Evidencë 158_Kontrolli i materialeve mësimore për lektorët PT
Evidencë 159_Korrenspondeca_Komunikimi Lektori Titullar dhe Lektori PT
548 Evidencë 90_Raport monitorimi të mësimit online Rezultate Teams
549 Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës
550 Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit
551 Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
552 Evidencë 1_Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, 2015
553 Evidencë 99_Manual afatet e akreditimit IAL dhe programet, 2017
554 Evidencë 73_Pyetësor shpërndarë ekspertëve për përmirësimin e kurrikulave

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | ***Po.*** Nëpërmjet web-it të UAMD[555], komunikimeve më email, takimeve informuese dhe publikimet në rrjetet sociale studentët informohen peridiokisht për organizimin, strategjitë, politikat, veprimtaritë dhe masat e marra për ecurinë dhe përmirësimin e cilësisë. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | ***Po.*** Rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit iu vihen në dispozicion personelit akademik, edhe publikohen për studentët dhe aktorët e tjerë, duke respektuar etikën akademike dhe legjislacionin për të dhënat personale[556]. UAMD në mënyrë periodike realizon takime dhe aktivitete me qëllim njohjen me rezultatet e vlerësimit të programeve të studimit. Këto takime kanë formën e diskutimeve dhe bashkëbisedimeve mbi materialet finale të raporteve të vetëvlerësimit sic edhe është parashikuar në Rregulloren e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë[557]. |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | ***Po.*** Fakulteti i Biznesit dhe njësia bazë e programit të studimit vihet në dijeni nga DSKC (NJSBC) mbi vlerësimin periodik të lektorëve me kohë të plotë dhe kohë të pjessshme, dhe për cdo rast specifik diskutohet me lektorin e lëndës. Ky vlerësim ndikon në marrjen e masave në mënyrë të vazhdueshme për përmirësime të mëtejshme ndaj stafit akademik të angazhuar në programin e studimit[558]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të | ***Po.*** Në mënyrë periodike, nga analizat e programit të studimit [559], Analiza e departamentit FK[560] dhe Analiza e Fakultetit të Biznesit[561] vlerësohet ecuria e politikave dhe strategjive të ndjekura. Ata marrin masat e nevojshme për |

[555] https://uamd.edu.al/transparenca/
[556] Evidencë 10_Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UAMD
